

**ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË 2013:
Vështrim i përgjithshëm dhe
rekomandimet për reformën zgjedhore**

Ky publikim është pjesë e projektit “Demokracia e brendshme në partitë politike”, i realizuar nga “KIPRED” nga “Prishtina”, i financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme e mbështetur nga Qeveria Suedeze. Të gjitha përmbajtjet e këtij publikimi përfaqësojnë qëndrimet e autorëve dhe nuk reflektojnë medoemos mendimet Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme.



Përgatitur nga: Albert Krasniqi

Të drejtat autoriale © 2014 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në info@kipred.org ose +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rr. “Rexhep Mala” Nr. 5/A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel dhe Fax: +381 38 227 778
www.kipred.org

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	4
I. Hyrje.....	5
II. Korniza ligjore	6
III. Klima politike parazgjedhore.....	7
Data e shpalljes së zgjedhjeve	7
Heqja e stemës nga fletëvotimet.....	7
Përfshirja e OSBE-së në Veri.....	9
Certifikimi i Iniciativës Qytetare “Srpska”	10
Misioni i BE-së për monitorimin e zgjedhjeve.....	10
IV. Zgjedhjet brenda partiake dhe nominimet për zgjedhjet lokale	11
V. Fushata zgjedhore.....	14
Financimi i fushatave zgjedhore dhe shpenzimet	16
VI. Procesi zgjedhor	17
Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve	17
Dita e zgjedhjeve.....	18
Shpallja e rezultateve	21
Edukimi dhe informimi i votuesve	21
Ankesat dhe Gjobat.....	22
Rinumërimi	23
Rivotimi.....	24
Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave	24
VII. Rezultatet përfundimtare	26
VIII. Inaugurimi i kuvendeve komunale	28
Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Mitrovicë Veriore	29
IX. Rekomandimet për reformën zgjedhore	31

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
BE	Bashkimi Evropian
BE MVZ	Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
DnV	Koalicioni i OJQ-ve “Demokracia në Veprim”
ENEMO	Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropianë për Sundim të Ligjit në Kosovë
GIS	Iniciativa Qytetare “Srpska”
IQM	Iniciativa Qytetare për Malishevën
KFOR	Forcat e Aleancës Veri-Atlantike në Kosovë
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
SLS	Partia Liberale Serbe
SNPK	Partia Kombëtare e Serbëve të Kosovës
VV	Lëvizja VETËVENDOSJE!

I. HYRJJE

Deri më tani në Kosovë asnjë palë zgjedhje nuk janë mbajtur nën sistem të njëjtë zgjedhor, për t'ju nënshtruar kështu ndryshimeve të shumta eksperimentale. Në zgjedhjet e para të lira u votua me lista të hapura, për t'u mbyllur për një kohë e për t'u hapur sërish në zgjedhjet e vitit 2007, me mundësi të zgjedhjes deri në dhjetë kandidatë. Në zgjedhjet e vitit 2010 nga dhjetë kandidatë u shkurtua në pesë, kurse në zgjedhjet e fundit lokale vetëm për një kandidat. Këto ndryshime të shpeshta përveç që kanë shkaktuar konfuzion te votuesit duke rritur numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, po dëshmojnë edhe brishtësinë e përpjekjeve për të reformuar sistemin zgjedhor dhe gjetjen e një formule për përfaqësim sa më legjitim.

Ky punim është i dhjeti me radhë i KIPRED-it në fushën e zgjedhjeve dhe mëton të ofrojë një përshkrim kronologjik të procesit të zgjedhjeve lokale 2013, duke përfshirë klimën parazgjedhore si dhe efektet në zgjedhje të dialogut për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja e 19 prillit 2013 në mes të dy vendeve, në mes të tjerash synonte edhe organizimin e zgjedhjeve për herë të parë me ligjet e Republikës së Kosovës edhe në katër komunat veriore kryesisht të banuar nga komuniteti serb.

Zgjedhjet lokale 2013, organizoheshin pas atyre të përgjithshme të vitit 2010 të cilat u karakterizuan me parregullsi të shumta dhe manipulime të votave. Numër rekord i vëzhgueseve vendor dhe ndërkombëtar ishin akredituar për të monitoruar procesin, përfshirë edhe ata të 103 subjekteve politike të certifikuara për të garuar në zgjedhje, që së bashku përbënin numrin prej 30 mijë vëzhguesve. Përfshirja për herë të parë edhe e Prokurorisë së Shtetit, zotimi i subjekteve politike për një proces më të drejtë dhe transparent, ashpërsimi i dënimeve në Kodin Penal për krimet zgjedhore, jepte shpresë për një proces më të rregullt.

Me qëllim të përmirësimit të sistemit zgjedhor, në Kuvendin e Kosovës ishte krijuar një komision i veçantë për ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, punimet e të cilit kishin mbetur peng i mos-vullnetit të liderëve të partive politike për të arritur një marrëveshje për këtë çështje. Për këtë arsye, ky punim po ashtu analizon edhe kornizën ligjore dhe efektet zgjedhore nga perspektiva gjinore, për të përfunduar me disa rekomandime që kanë të bëjnë me reformën zgjedhore, si pragu zgjedhor, votimit jashtë Kosovës, por edhe disa rekomandime më teknike si kabinat e votimit që mund të ndikojnë në rregullsinë e procesit.

II. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për zgjedhjet në Kosovë është e përcaktuar nga Kushtetuta, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjit për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike si legjislacion primar, por pjesë të caktuara për zgjedhjet lokale rregullohen edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal. Kushtetuta e Kosovës (Neni 81) Ligjin për zgjedhjet lokale si dhe atë për kufijtë administrativ i konsideron si pjete të legjislacionit me Interes Vital, për ndryshimin ose shfuqizimin e të cilave kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë. Madje, asnjëra nga këto ligje nuk i nënshtrohen referendumit.

Ligji i vetëm i cili ka pësuar ndryshime substanciale për këto zgjedhje, është Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, dhe atë vetëm tre muaj para datës së mbajtjes së zgjedhjeve. Ndër ndryshimet më të rëndësishme që janë bërë këtij ligji i takon ndalimit të donacioneve nga ndërmarrjet private gjersa dhe tre vite pas përfundimit janë në marrëdhënie kontraktuale me institucionet e Republikës së Kosovës.¹ Poashtu, me këto ndryshime është adresuar edhe detyrimi që subjektet politike të kenë vetëm një llogari bankare dhe të gjitha transaksionet t'i kryejnë përmes kësaj llogarie, e që ka qenë një nga rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2012. Ligji tani parasheh gjoba dhe sanksione më të ashpra për subjektet të cilat nuk respektojnë legjislacionin.² Nëse nuk paraqitet raporti vjetor financiar dhe ai i fushatës zgjedhore, subjektet parlamentare gjobiten me 10% të shumës së realizuar nga Fondi në vitin paraprak, si dhe me gjobë ditore prej 0.01% të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Për informata të pasakta dhe jo të plota që lidhen me bilancin e gjendje, e që janë në vlerë mbi 5 mijë euro, gjobiten me 5 mijë euro. Për mungesë të kopjeve të dokumentacionit financiar, gjobiten me 2 mijë euro. Nëse marrin donacione në kundërshtim me ligjin, gjobiten me dyfishin e shumë së pranuar, ndërsa nëse nuk mund të dëshmojnë origjinën e mjeteve të pranuar nga donacionet e që janë në vlerë mbi 20 mijë euro, gjobiten me trefishin e asaj shume. Ligji gjithashtu nxitë edhe krijimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm financiar përmes detyrimit të subjekteve politike të definojnë këtë mundësi në statutet e tyre,³ me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës.

Mirëpo, përmes këtyre ligjeve vetëm pjesërisht dhe në terma të përgjithshëm rregullohet organizmi i zgjedhjeve dhe veprimtaria e subjekteve politike, pasi pjesa më e madhe bëhet përmes legjislacionit sekondar, me anë të rregullave zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Deri më tani ky institucion ka nxjerrë 17 rregulla zgjedhore, përmes të cilave rregullon aspektet e zgjedhjeve, regjistrimit të partive politike dhe raportimit të tyre. KQZ përbëhet nga 11 anëtarë, katër prej tyre të rezervuar për komunitetet, kurse nga një anëtarë prej secilës nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Kryesuesi i KQZ-së emërohet nga Presidenti/ja e Republikës së Kosovës, dhe zgjidhet në mesin e 14

¹ Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, Neni 6.1

² Ligji Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L058, Neni 21

³ Po aty, Neni 9.1

gjqtarëve të Gjykatës Supreme apo Gjykatave me juridiksion apeli, duke kufizuar kështu për zgjedhjen të një grupi i ngushtë individësh. Formula e tanishme për përbërjen e KQZ-së mundëson dominim absolut të pozitës në raport me opozitën, e kur kësaj i shtohen edhe katër anëtarët që vijnë nga radhët e komuniteteve që zakonisht janë pjesë e koalicionit qeverisës, raporti në mes të dy palëve në të shumtën e rasteve është 7 me 3 në favor të pozitës. Dominimi i pozitës në përbërjen e KQZ-së rrezikon që legjislacioni sekondar t'i përshtatet interesave të pozitës, kurse propozimet që vijnë nga opozita shumë lehtë mund të bllokohen. Përbërja e tillë është e dëmshme dhe për faktin se KQZ gëzon kompetenca të shumta si pasojë e mungesave ligjore, por dhe se shumica e vendimeve në KQZ merr me shumicë të thjeshtë,⁴ përjashtim bëjnë miratimi apo ndryshimi i rregullave zgjedhore.

III. KLIMA POLITIKE PARAZGJEDHORE

Data e shpalljes së zgjedhjeve

Në bazë Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale, data e zgjedhjeve shpallet nga Presidenti i vendit në konsultim paraprak me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Legjislacioni zgjedhor⁵ mundëson që zgjedhjet lokale të mbahen 60 ditë para përfundimit të mandatit, por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tij. Asokohe në debatin politik dhe në opinionin publik mbizotëronte një pajtueshmëri e përgjithshme se zgjedhjet duhet të organizohen sa më herët që lejon afati ligjor.⁶ Opsioni i fundit që përmendej ishte fundi i shtatorit apo fillimi i tetorit, me qëllim t'i shmangej të ftohtit dhe ndërrimit të orës që shkakton shkurtimin e ditës. Në zgjedhjet e vitit 2010 ishte dëshmuar se manipulimet më të mëdha në vendvotime kishin ndodhur pikërisht gjatë orëve të mbrëmjes kur kishte probleme në furnizim me energji elektrike⁷.

Mirëpo, dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë ishte vendimtar në përcaktimin e datës së zgjedhjeve, dhe jo dialogu në mes partive politike i kryesuar nga Presidentja e vendit. Në fund, ishte kryeministri serb Ivica Dačić, ai që deklaroi për arritjen e marrëveshjes me kryeministrin kosovar Hashim Thaçi, dhe se data e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Kosovë ishte përcaktuar 3 nëntori. Ashtu edhe ndodhi, pas dhjetë ditësh Presidentja Jahjaga shpalli vendimin që zgjedhjet lokale në Kosovë të mbahen më 3 nëntor 2013.⁸ Ky akt përbën precedent negativ për rendin demokratik në Kosovë, pasi përkundër kompleksitetit të pjesëmarrjes së serbëve në veri në zgjedhje, data u përcaktua nga rezultatet e dialogut me Serbinë, pa marrë parasysh konsultimet paraprake me të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend.

Heqja e stemës nga fletëvotimet

Gjatë dialogut në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kryeministri Dačić negocionte në emër të qytetarëve serb të Kosovës dhe vendoste kushtet e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhjet lokale. Një ndër këto kushte ishte edhe heqja e simboleve të shtetit të Kosovës nga të gjitha materialet zgjedhore në komunat me shumicë serbe, me arsyetimin se kjo do të mund të

⁴ Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 63.4

⁵ Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, Neni 4.2

⁶ "Zgjedhjet lokale në fund të shtatorit", Telegrafi. Qasur më 26 nëntor 2013, <http://www.telegrafi.com/lajme/zgjedhjet-lokale-ne-fund-te-shtatorit-2-31491.html>.

⁷ Demokracia në Veprim. Prishtinë, 2011. *Raport i vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare 2010*, fq.38

⁸ "Vendimi i Presidentes Jahjaga për shpalljen e zgjedhjeve lokale në Kosovë". Qasur më 13 nëntor 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2942>.

interpretohej si njohje e Kosovës nga ana e Serbisë. Poashtu, kërkesa e Beogradit përmes fletëvotimeve jo uniforme për krejt territorin e Kosovës, do të instalonte një praktikë shumë e dëmshme që hapë rrugë për dualitet të rendit juridik në Kosovë, përmes të cilit veriu do të trajtohet si territor i veçantë.

Kërkesa për heqjen e stemës shtetërore nga fletëvotimet ishte përcjellë me debate të ashpra brenda KQZ-së, madje anëtari i saj nga radhët e AKR-së Fadil Maloku ishte shkarkuar nga Presidentja pas kërkesës së subjektit të tij politik. AKR e mbështeste kërkesën për shkarkim me pretekstin se ky i fundit nuk kishte mbrojtur interesin e partisë në KQZ, kurse Maloku thoshte se kërkesa për shkarkim ishte bërë pasi kishte kundërshtuar heqjen e simboleve nga fletëvotimet. Përplasjet politike në mes anëtarëve të KQZ-së kishin krijuar një ambient të papërshtatshëm pune, shpeshherë mbledhjet e KQZ-së shtyeshin dhe thirreshin në mënyrë jo-transparente, që e pengonte edhe procesin e përgatitjeve për zgjedhjet lokale. Në mbledhjen e thirrur nga KQZ për datë 2 shtator 2013, ftesa te anëtarët e saj ishte dërguar një ditë më herët dhe atë në ora 23:00, si mbledhje e jashtëzakonshme. Në agjendë ishte futur vetëm një pikë e rendit të ditës, që kishte të bënte me kërkesën e Ministrisë së Diasporës për zgjatjen e periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë vendit. Në dukje, kërkesë teknike dhe aspak e jashtëzakonshme, pasi ishte pranuar qysh me datë 20 gusht, dhe ishte shqyrtuar paraprakisht në këshillin e procedurave që përbëhet nga anëtarët e KQZ-së. Për këtë takim KQZ nuk kishte njoftuar përfaqësuesit e mediave⁹ duke u munduar që takimin ta mbajë të fshehtë. Takimi i KQZ-së i paraparë të mbahet në ora 11:00 ishte shtyrë për ora 12:00, pastaj ishte anuluar fare, për tu ri-caktuar sërish për ora 16:15.¹⁰ Nxitimi i KQZ-së për të mbajtur takim të jashtëzakonshëm dhe larg përfaqësuesve të mediave në të vërtetë nuk kishte të bënte me kërkesën e Ministrisë së Diasporës, por me pikën e tretë e cila u propozua nga përfaqësuesi i SLS-it në KQZ, që kishte të bënte me miratimin e përmbajtjes (Formës- Dizajnit) të fletëvotimit për zgjedhjet lokale 2013.¹¹

Përfundimisht, në këmbim të pjesëmarrjes së komuniteti serb në zgjedhje, më 2 shtator 2013 KQZ kishte miratuar fletëvotimet pa stemën e Kosovës, përkatësisht vetëm me logon e KQZ-së,¹² për të plotësuar kështu edhe një kërkesë të Beogradit me të cilën ishte pajtuar Prishtina. Heqja e simboleve ishte bërë vetëm nga fletëvotimet, pasi stema ishte e pranishme në të gjitha materialet tjera zgjedhore, duke përfshirë formularët e rezultateve. Vendimi për heqjen e simboleve nga të gjitha fletëvotimet në Veri u përcoll me reagime të ashpra nga shoqëria civile dhe opozita në Kosovë duke e cilësuar si neutralizim të shtetësisë së Kosovës dhe shkelje kushtetuese.¹³ Mirëpo, në anën tjetër, legjislacioni i Kosovës nuk përcakton qartë dizajnin e fletëvotimit dhe vendosjen e simboleve shtetërore në fletëvotime. Ky vendim i KQZ-se në esencë nuk paraqiste shkelje flagrante ligjore apo kushtetuese, por mënyra se si u bë ky ndryshim ishte kontestuese.

⁹ Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 11.9, obligon KQZ-në që takimet t'i ketë të hapura për vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave

¹⁰ "Fletëvotimet pa simbolet e Kosovës, vetëm me logon e KQZ-së", Portali Koha. Qasur më 3 nëntor 2013, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,157449>.

¹¹ Komunikatë për Media e KQZ-së, <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/98>

¹² Po aty

¹³ "Vetëvendosje do ta dërgojë në gjykatë vendimin e KQZ-së për heqjen e stemës", NOA. Qasur më 5 dhjetor 2013, <http://www.noa.al/artikull/vetevendosje-do-ta-dergoje-ne-gjykate-vendimin-e-kqz-se-per-heqjen-e-stemes/360591.html>

Përfshirja e OSBE-së në Veri

Pika e 12-të e marrëveshjes së 19 prillit 2013 në mes të Kosovës dhe Serbisë, i bënte thirrje misionit të OSBE-së të lehtësoj procesin zgjedhor në komunat e veriut në bazë të ligjeve të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare. Nuk ishte e qartë nëse “lehtësimi” i procesit zgjedhor nënkuptonte që KQZ-ja do të jetë trupi menaxhues kryesor për organizimin e zgjedhjeve dhe OSBE-ja do të kishte rol këshillues dhe të ndihmësit teknik, ose, nëse siç ndodhi në realitet, OSBE-ja të udhëheq të gjithë procesin në komunat e veriut, me qasje shumë të kufizuar të KQZ-së. Mungesa e një marrëveshje për përcaktimin e përgjegjësive solli deri te një situatë ku KQZ-ja nuk dinte se çfarë është duke ndodhur me përgatitjet për zgjedhje në komunat në veri, dhe kërkonte raport nga OSBE-ja lidhur me përgatitjet që po bëheshin atje.¹⁴ Edhe pse publikisht dhe zyrtarisht anëtarët e KQZ-së kërkonin raport nga OSBE-ja, kjo e fundit hezitonte të raportonte rreth aktiviteteve dhe përgatitjeve në veri, dhe një raport i tillë nuk u dorëzua deri më 2 nëntor, një ditë para ditës së zgjedhjeve.¹⁵

Në mungesë të regjistrimit të saktë civil për komunat e veriut, përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit kishin rënë dakord që OSBE-ja të ndihmojë në procesin e grumbullimit të aplikacioneve për votuesit jashtë Kosovës, nga Serbia dhe Mali i Zi, në mënyrë që të verifikohen personat që kanë të drejtë juridike për të votuar në Kosovë. Gjatë procesit zgjedhor OSBE-ja kishte ndërmjetësuar votimin jashtë Kosovës për personat e zhvendosur,¹⁶ përmes themelimit të një qendre të grumbullimit të vendosur në Nish, si dhe krijimin e ekipeve mobile për të ndihmuar personat e zhvendosur të votojnë përmes postës. Detyrat e qendrës së grumbullimit në Nish kanë përfshirë pajisjen me informata për rregullat dhe procedurat, shpërndarjen e formularëve për aplikim për votim jashtë Kosovës, grumbullimin e këtyre aplikacioneve, transmetimin e njoftimeve për të drejtën e votimit nga KQZ, grumbullimi dhe transmetimi i zarfeve që përmbajnë zarfet e fshehtësisë tek KQZ në Prishtinë.

Nga pikat e grumbullimit në Serbi dhe Mal të Zi, OSBE-ja kishte arritur të grumbulloj rreth 40 mijë aplikacione të cilat i kishte dorëzuar në KQZ për verifikim. Numri i madh dhe i papritur i aplikacioneve shkaktoi barrë të madhe mbi Sekretariatit e KQZ-së të cilët kishin shumë pak kohë që të verifikonin aplikacionet, një nga një. Gjatë procesit të verifikimit, raportohet se një numër i madh i aplikacioneve po refuzoheshin.¹⁷ Pas shqyrtimit të aplikacioneve KQZ kishte aprovuar vetëm 8,383 aplikacione për t’i regjistruar si votues me të drejtë vote. Korniza ligjore lejon apel në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ndaj vendimit të KQZ-së për refuzimin e aplikacionit për të votuar jashtë Kosovës. OSBE e shqetësuar me numrin e madh të refuzimeve, kishte ndërhyrë pa paralajmërim dhe jashtë mandatit në QNR në Fushë Kosovë ku po zhvillohej procesi i verifikimit, për të analizuar një mostër të aplikacioneve.¹⁸ OSBE-ja e kishte shfrytëzuar të drejtën për apel si metodën e fundit për të ju mundësuar votimin këtyre votuesve,

¹⁴ “KQZ kërkon nga OSBE raport urgjent për procesin zgjedhor në veri”, KosovaLive360. Qasur më 12 dhjetor 2013, <http://www.kosovalive360.com/kqz-kerkon-nga-osbe-raport-urgjent-per-procesin-zgjedhor-ne-veri.html>.

¹⁵ “KQZ i gatshëm për të dielën, vërejtje të shumta OSBE-së”, Portali Koha. Qasur më 13 dhjetor 2013, http://koha.net/arkiva/index.php?page=1,13,164226&s=&ch=0&f_d=02.11.2013&t_d=02.11.2013.

¹⁶ Sipas Rregullës së KQZ-së Nr.3/2013 Votimi jashtë Kosovës, të drejtë votimi kanë të gjithë ata persona të cilët jetojnë jashtë Kosovës, por që janë të regjistruar si qytetarë të Kosovës në Regjistrin Qendror Civil. Fjala është për persona që kanë lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit të vitit 1998.

¹⁷ “Ndërhyrje në punët e KQZ’së”, Portali Lajmi. Qasur më 13 dhjetor 2013, <http://lajmi.net/nderhyrje-ne-punet-e-kqzse>.

¹⁸ Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 16.5

dhe kishte dorëzuar 16,000 apele nga palët e refuzuara. Pas shqyrtimit të apeleve në një periudhë prej afër shtatë ditëve, PZAP kishte hedhur poshtë vendimet e KQZ-së për refuzim në rreth 5,000 raste, duke e rritur numrin në gjithsej 13,841 votues me postë nga Serbia dhe Mali i Zi.

Certifikimi i Iniciativës Qytetare “Srpska”

Zotimi i Serbisë për shuarjen e strukturave paralele ilegale në Kosovë, rezultoi me instalimin e influencës direkte politike përmes krijimit të një subjekti të saj në Kosovë. Në Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim në Kosovë, pranë KQZ-së, kishte aplikuar për certifikim Iniciativa Qytetare “Serbija”. Fillimisht, KQZ kishte refuzuar të certifikoj këtë iniciativë duke kërkuar të ndryshoj emrin pasi përbënte shkelje të rregullave të KQZ-së për regjistrim,¹⁹ sepse emri i paraqitur mund të nxisë urrejtje apo dhunë ndëretnike apo religjioze.

Sikurse të gjitha çështjet e tjera rreth pjesëmarrjes së komunitetit serb në zgjedhje, as kjo e emrit nuk kaloi pa u diskutuar në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë. Rezultati i bisedimeve rezultoi në ndryshimin e emrit nga Iniciativa Qytetare “Serbija” në Iniciativa Qytetare “Srpska”, për t’u certifikuar pastaj nga KQZ-ja. Pas kësaj, Beogradi për herë të parë bëri thirrje drejtuar komuniteti serb që jeton në Kosovë të merr pjesë në zgjedhje, por kjo thirrje ishte e shoqëruar edhe me preferencën që të votohet për Iniciativën Qytetare “Srpska” e jo për subjektet tjera politike të popullatës serbe në Kosovë. Qëllimi i Beograd ishte që përmes këtij subjekti politik të vendos kontrollin e plotë ndaj popullatës serbe që jeton në Kosovë, si dhe të shkatërroj opsioneve tjera politike të serbëve lokal të cilët ishin në koalicion qeveritar dhe të afërt me Prishtinën. Përmes kësaj, Beogradi u bë faktor bashkë qeverisës në Kosovë, duke e instaluar praktiken e ngjashme të ndikimit që ka bashkë me Zagrebin në skenën e brendshme politike në Bosnje dhe Hercegovinë pas arritjes së marrëveshjes së Dejtonit.

Misioni i BE-së për monitorimin e zgjedhjeve

Për të monitoruar nga afër zbatimin e marrëveshjeve të arritura nën lehtësimin e vet, BE-ja kishte kërkuar që të bëjë vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Kosovë përmes monitoruesve të saj. Për të përmbushur këtë kërkesë të BE-së, ashtu edhe si është bërë praktikë në relacionet në mes BE-së dhe Kosovës, Presidentja Jahjaga, i drejtohet me një letër²⁰ Përfaqësueses së Lartë për Politikë të Jashtme të Bashkimit Evropian Catherine Ashton, ku i bën thirrje të dërgoj një mision për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Pas konsultimeve me shtetet anëtare dhe Parlamentin Evropian, baronesha Ashton përgjigjet pozitivisht²¹ duke dërguar Misionin Monitorues të Zgjedhjeve të BE-së, në përbërje prej 99 monitoruesve. Në përbërje të këtij misionin ishin përfaqësues të 28 vendeve anëtare të BE-së, si dhe Zvicrës dhe Norvegjisë, ndërsa ekipi udhëhiqej nga një deputet i Parlamentit Evropian. Pas përfundimit të zgjedhjeve të raundit të parë, ky mision kishte dal me raport preliminar rreth mbarëvajtjes së zgjedhjeve, që kishte në fokus vlerësimin nëse procesi zgjedhor ishte në pajtim me zotimet ndërkombëtare të zgjedhjeve si dhe ligjet e Kosovës. Raporti kishte konstatuar se përgatitjet për zgjedhje nuk ishin zhvilluar

¹⁹ Rregulla e KQZ-së Nr. 1/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Neni 5, pika c.

²⁰ “Letra e Presidentes Jahjaga drejtuar baroneshës Chatherine Ashton”. Qasur më 15 dhjetor 2013, <http://president-ksgov.net/?page=1,6,2973>.

²¹ “Përgjigja e baroneshës Ashton drejtuar Presidentes”. Qasur më 15 dhjetor 2013, <http://president-ksgov.net/?page=1,6,3057>.

njëjtë në gjithë territorin e Kosovës për shkak të situatës specifike në veri,²² përderisa lavdëron kornizën ligjore të Kosovës dhe zotimin e saj për të përmbushur parimet e konventave ndërkombëtare për zgjedhjet, si dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, përkundër se Kosova nuk ka nënshkruar asnjë zotim ndërkombëtar.

IV. ZGJEDHJET BRENDIAKE DHE NOMINIMET PËR ZGJEDHJET LOKALE

Para datës së mbajtjes së zgjedhjeve lokale, PDK, AAK dhe AKR kishin kaluar nëpër procesin e zgjedhjeve të brendshme, ndërsa LDK dhe VV planifikojnë që ato t'i mbajnë pas zgjedhjeve lokale. Legjislacioni në fuqi obligon partitë politike të organizojnë zgjedhje të brendshme së paku çdo 48 muaj,²³ në të kundërtën nuk mund të certifikohen për të marrë pjesë në zgjedhje. Organizimi i zgjedhjeve të brendshme dhe nominimi i kandidatëve për zgjedhjet lokale në shumicën e subjekteve politike ishte formal, sa për të kënaqur kërkesat ligjore, pasi të gjithë kryetarët aktual të partive u rizgjodhën pa kundër kandidat. Situata e ngjashme ishte edhe nëpër degë, kryetarët dhe kandidatët për kryetar të komunave u zgjedhën në bazë të preferencave të liderëve, madje në disa raste u zgjedhën kundër vullnetit të anëtarësisë.

Partia Demokratike e Kosovës - Zgjedhjet e brendshme në PDK konfirmuan edhe një herë për kryetar të saj Hashim Thaçin i cili qëndron në krye të këtij subjekti politik prej 13 viteve. Në Konventën e VI-të zgjedhore të partisë të mbajtur më 26 janar 2013, Hashim Thaçi ishte kandidati i vetëm për kryetar, i cili u zgjedh me votim të hapur dhe vetëm me një votë kundër nga 719 delegatë të pranishëm. Për ironi, Thaçi ishte i vetmi i cili kishte votuar në favor të votimit të mbyllur, pasi që delegatët me shumicë vendosën për votim të hapur.²⁴ Në Konventën e PDK-së nuk kishin marrë pjesë nënkryetari i deriatëhershëm Fatmir Limaj dhe sekretari i përgjithshëm Jakup Krasniqi të cilët edhe pse nuk qenë prezent u propozuan nga kryesia për anëtarë të kryesisë në Këshillin e Përgjithshëm.²⁵ Konventa zgjedhore sinjalizoi fillimin e pakënaqësive më të mëdha të brendshme në PDK, e që rezultoi me shkëputje të organizuara nga degët e saj dhe konflikte të hapura në mes pretendentëve. Anëtarët e kryesisë, Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi, të pakënaqur me trajtimin brenda subjektit të tyre kishin vendosur të përkrahin Inicativën Qytetare në Malishevë respektivisht Drenas, të krijuara rishtazi nga ish-anëtarë të PDK-së në këto degë.

Telashet e PDK-së me degët “problematike” u hasën edhe në degën e Lipjanit, kryetari i së cilës së bashku me 19 anëtarë të tjerë kishin dhënë dorëheqje²⁶ për të krijuar Inicativën Qytetare për Lipjanin të cilët më pastaj kaluan në AAK. Mos përfillja e vullnetit të degëve dhe centralizimi i pushtetit në qendër të partisë u has edhe në degën e Vitisë. Në bazë të rezultateve nga zgjedhjet e

²² BE MVZ. 2013. *Deklaratë preliminare*. Shiko tek http://www.eucm.eu/files/pressreleases/other/preliminary-statement-in-kosovo-05112013_sq.pdf

²³ KQZ, Rregulla Nr.1/2013, për regjistrimin dhe veprimin e partive politike, neni 15.1

²⁴ “Një votë kundër Hashim Thaçit akt simbolik i demokracisë”, Gazeta JnK. Qasur më 20 dhjetor 2013, <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,4534>.

²⁵ “Krasniqi e Limaj propozohen për Këshillin Drejtues të PDK-së”, Gazeta JnK. Qasur më 20 dhjetor 2013, <http://gazetajnk.com/?cid=1%2C1018%2C4530>.

²⁶ “Kryetari i PDK-së së Lipjanit, Fitim Selimi, vetinentëmbdhjeti ka dhënë dorëheqje”, Kosova Live 360. Qasur më 22 dhjetor 2013, <http://www.kosovalive360.com/kryetari-i-pdk-se-se-lipjanit-fitim-selimi-vetinentemdhjeti-ka-dhene-doreheqje.html#sthash.IOMP2Tbj.dpbs>.

brendshme në këtë degë, kryesia dhe këshilli drejtues i degës kishin propozuar dhe votuar për kandidat të komunës së Vitisë Xhevat Bislimin, ndërsa qendra e PDK-së kishte përkrahur kryetarin e deriatëhershëm të komunës Nexhmedin Arifin, emrin e të cilit e kishin dërguar për certifikim në KQZ, pa pëlqimin e degës së Vitisë.²⁷ Pa probleme nuk mbetën as dega e Gjilanit dhe Ferizajt. Pas shumë zvarritjeve dhe përplasjeve ndërmjet pretendentëve për kryetar të degës së PDK-së në Gjilan, dhe me ndërmjetësim të kryetarit të partisë Hashim Thaçi, i cili kishte arritur të bindë kryesinë e degës që me konsensus të votoj Zenun Pajazitin për kryetar të degës së Gjilanit dhe kandidat për kryetar të kësaj komune. Nuk kishte zgjatur shumë, që Zenun Pajaziti të jep dorëheqje nga të gjitha funksionet në degë, për t'i lënë vendin Qemajl Mustafës i cili u zyrtarizua si kandidat për kryetar të komunës, edhe pse nuk ishte zgjedhur në fillim. Dega e Prishtinës kishte tensione në mes të kandidatëve për kryetar të degës, e cila mirë u menaxhuan nga brenda dhe palët u pajtuan me rezultatin. Ndërsa për kandidatë për kryetarë të komunës së Prishtinës, në minutat e fundit dhe për habinë e të gjithëve, madje edhe të vet kandidatit, ishte vendosur të jetë ministri i FSK-së Agim Çeku, i posa aderuar në PDK.

Në komunat e tjera ku PDK kishte udhëhequr deri atëherë, kryesia kishte vendosur që t'i rikandidoi edhe për një mandat të gjithë kryetarët ekzistues, duke përfshi edhe ata të cilët ishin nën hetime për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Nëntë kryetar të komunave nga PDK, të dalë nga zgjedhjet lokale 2009, janë të akuzuar apo veç janë dënuar nga gjykatat e vendit.²⁸ Në mesin e kandidatëve të akuzuar dhe që rikandidonin ishte edhe kryetari i Skenderajt Sami Lushtaku, i cili gjendej në paraburgim pasi akuzohet për krime lufte, si dhe ai i Prizrenit Ramadan Muja, i cili akuzohet për keqpërdorim të pronave publike dhe komunale. Në këtë mënyrë, PDK si parti e cila udhëheq me sektorin ekzekutiv të vendit anashkaloi atë legjislativ, duke mos marrë në konsideratë proceset gjyqësore që ishin nisur ndaj zyrtarëve të saj. Madje, nuk morri në konsideratë as mundimin që mund të shkaktoj te qytetarët e këtyre komunave, ngase në rast të konfirmimit të akuzës, në këto komuna duhej të organizoheshin zgjedhje të reja.

Lidhja Demokratike e Kosovës – Të fundit herë kur LDK ka organizuar zgjedhje të brendshme ishte nëntori i vitit 2010, çka do të thotë se ky subjekt nuk është i obliguar të mbaj zgjedhje të brendshme para fundit të vitit 2014. Sipas statutit të LDK-së, kryesia shqyrton dhe miraton sugjerimet për zgjedhjet lokale të kryetarëve të komunave nga udhëheqja komunale e degëve të partisë (Neni 30). Ndërsa, nominimi dhe miratimi i kandidatëve për listat zgjedhore në kuvendet komunale vendosen nga degët (Neni 45.4), në bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, në njërin nga takimet me qytetarë gjatë fushatës zgjedhore kishte deklaruar se rotacioni politik është i domosdoshëm, në të kundërtën demokracia rrezikon të stërkeqet.²⁹ Por, kishte harruar se edhe ai vetë po kandidonte për mandatin e tretë me radhë në Prishtinë. Kandidimi i Isa Mustafës nuk ishte zyrtarizuar deri në momentet e fundit, pasi shumë emra të tjerë kishin qarkulluar si opsion për kandidatë të LDK-së. Për më tepër, kjo parti kishte

²⁷ Kryesia e degës së PDK-së në Viti paralajmëron ankesë në Kushtetuese”, Portali Koha. Qasur më 8 janar 2014, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,17,163189>.

²⁸ Çollaku, Petrit, “Dhjetë kryetar komunash të akuzuar ose dënuar”, Gazeta JnK. Qasur më 12 janar 2014, <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,5757>.

²⁹ “Cilit Isa Mustafë t'i besojmë”, Lajm Online. Qasur më 12 janar 2014, <http://www.lajmonline.com/sq/Politike/Cilit-Isa-Mustafe-ti-besojme-33875>.

kohë që proklamonte kryetarin e saj si kryeministër të ardhshëm të vendit, që e bënte kontradiktore edhe kandidimin për komunën e Prishtinës, poste këto që nuk mund të mbahen njëkohësisht. Përveç që Isa Mustafa kishte vendosur të ri-kandidonte për Prishtinën, për të mos rrezikuar me kandidat tjerë, kishte rikthyer në garë edhe kryetarët e dikurshëm të komunës së Prizrenit, Gjilanit dhe Suharekës. Kryetarët e komunave nga radhët e LDK-së u ri-kandiduan, ndërsa kandidatët në komunat e tjera u gjendën brenda partisë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Për një kohë të gjatë ky subjekt kishte funksionuar pa kryetar i cili ishte në proces gjyqësor në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës për Krime të Luftës në Ish-Jugosllavi. Pas kthimit të tij, ishin organizuar zgjedhjet të brendshme, ndërsa me 4 maj 2013 ishte mbajtur Kuvendi i VI-të zgjedhor, nga ku janë zgjedhur strukturat e partisë. Edhe për një mandat katër vjeçar është rizgjedhur për kryetar Ramush Haradinaj, i cili mbanë këtë pozitë që nga themelimi i partisë. Haradinaj ka marrë 403 vota nga 404 delegatë të pranishëm, në një garë pa kundërkandidat, por me votim të fshehtë. Dëshira e kryetarit Haradinaj ishte të vazhdoj punën me ata anëtarë të kryesisë të cilët i kishte lënë në momentin që kishte shkuar në Hagë.³⁰ Si rrjedhojë, zgjedhjet e brendshme në AAK shërbyen për të legjitimuar dëshirat e kryetarit të partisë, ngase këtë ja mundëson edhe statuti. Kryetari ka të drejtën për të nominuar kryesinë, nënkryetarët, sekretarët, dhe anëtarët e tjerë në të gjitha nivelet (Neni 23), të cilët më pastaj aprovohen nga Këshilli Drejtues, një e treta e anëtarëve të së cilës emërohen nga kryetari. Madje, për një çështje të votuar nga Këshilli Drejtues, për një here kryetari ka të drejtën e vetos (Neni 23.6).

Në AAK vendimet mbi kandidatët për kryetar komune bëhen nga një grup pune në Kryesi e cila i dërgon përpara propozimet në Këshillin e Përgjithshëm. Në praktikë ka ndodhur që kryetari të zgjedhë kryetarin e degës pa konsultime paraprake me organet tjera të partisë. Në zgjedhjet e fundit në degën e Mitrovicës, kryetari i kësaj dege është zgjedhur direkt nga kryetari i partisë me arsyetimin se “në zgjedhjet e kaluara të degës i kemi hapur listat, po mandej kemi pasur problem ti mbyllim ato”.³¹ Ndërsa nominimi i kandidatëve për lista zgjedhore është kompetencë e degëve.

Aleanca Kosova e Re - Edhe AKR gjatë vitit 2013 organizojë zgjedhje të brendshme në të gjitha strukturat e saj, duke filluar nga nëndegët, degët dhe forumet tjera. Në Kuvendin e III-të zgjedhor, AKR edhe për një mandat tre vjeçar ka zgjedhur për president Behxhet Pacollin, i cili ishte i vetëm në garë, pa kundër kandidat dhe pa asnjë votë kundër.³² Pacolli është themelues dhe financues kryesor i këtij subjekti politik që nga fillimi. Gjatë kohës sa kishte shërbyer si President i vendi, Pacolli ishte zëvendësuar përkohësisht në krye të partisë nga kushëriri i tij, për të mos lënë kështu partinë jashtë kontrollit të familjes.

Statuti i AKR-së i'u mundëson degëve të propozojnë listat e kandidatëve për kuvendet komunale si dhe kandidatët për kryetar të komunave (Neni 14), mirëpo kryesia qendrore merr vendim përfundimtar në bashkëpunim me degët. Përmbi kryesinë qendrore dhe degët qëndron presidenti i AKR-së, i cili edhe me statut gëzon privilegje të shumta. Ai ka të drejtën të propozoj dhe refuzoj listën e kandidatëve për zgjedhje në të gjitha nivelet, madje edhe t'i propozoj kryesisë

³⁰ Deklarim i Anton Berisha, anëtar i kryesisë së AAK-se në Klan Kosova, 24 dhjetor 2013

³¹ Deklarim i kryetarit të AAK-së z. Ramush Haradinaj në zgjedhjet e degës së Mitrovicës

³² “Behgjet pacolli rizgjedhet president i AKR-së”, Komunikatë e AKR-së. Qasur më 25 janar 2014, <http://akr-ks.com/article/behgjet-pacolli-rizgjedhet-president-i-akr-se/>.

marrjen e vendimit për shpërndarjen e kryesisë së degës (Neni 31). Nominimi i kandidatëve për zgjedhjet lokale në AKR ishte përcjell me probleme në degën e Gjilanit. Kryetari i ri-zgjedhur edhe për një mandat Omer Daku, ishte shkarkuar pas katër muajve nga presidenti Pacolli,³³ me arsyetimin se kishte tentuar të lërë jashtë garës këtë subjekt duke mbështetur një subjekt tjetër. Kryetari i degës z. Daku, i cili kishte ambicie për të garuar edhe një herë për kryetar të komunës,³⁴ ishte zëvendësuar nga Faton Bislimi, fillimisht në postin e kryetarit të degës, pastaj edhe atë të kandidatit për kryetar të komunës. Ndërsa për kandidatin për kryetarë të komunës së Prishtinës ishin spekuluar emra të shumtë të cilët do të garonin për këtë post. Në fund, në pamundësi të gjetjes së një kandidati serioz brenda partisë, ishte rekrutuar nga LDK-ja Korab Sejdiu. Nominimi i Sejdiut ishte bërë direkt nga Pacolli, që kishte shkaktuar edhe pakënaqësi të anëtarëve më të hershëm të degës.

Lëvizja VETËVENDOSJE! - Nga të paktat subjekte politike të cilat respektuan rregullat formale të demokracisë së brendshme dhe statutin e tyre ishte VV-ja. Për nominimin e kandidatëve për kryetar të komunave dhe kuvendet komunale, gjatë muajit gusht 2013, VV kishte organizuar zgjedhje të brendshme dhe anëtarët e saj kanë votuar për kandidatin e tyre të preferuar sipas parimit një anëtar një votë. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është ndarë në dy faza. Gjatë fazës së parë janë zgjedhur kandidatët për kryetar të komunave, të cilët sipas statutit (neni 82.2) propozohen ose vetëpropozohen duke mbledhur 1/5 e nënshkrimeve të aktivistëve të një qendre të VV-së, ose duke i mbledhur 1/5 e nënshkrimeve të delegatëve të Këshillit të Qendrës. Kandidatët për kryetar komune janë zgjidhur me votim në pika nga të gjithë aktivistët e komunës përkatëse. Ndërsa në fazën e dytë, janë përzgjedhur kandidatët për kuvendet komunale, kandidaturat e të cilëve janë shqyrtuar nga Këshilli i Qendrës. Kandidat për kuvende komunale mund të propozohen nga aktivistët e Këshillit të Pikës, të Këshillit të Qendrës ose vetëpropozohet, duke e drejtuar një kërkesë me shkrim në Këshillin e Qendrës.³⁵

Megjithëkëtë, në deklaratat e VV-së lidhur me ecurinë e zgjedhjeve të brendshme, asnjëherë nuk u bë e ditur nëse kishte më shumë kandidat në garë për kryetar të komunave. Në komunikatat për media të VV-së bëhej vetëm shpallja e fituesve, që në shumicën e rasteve ishin me mbi 95% të votave dhe pa asnjë ankesë të deponuara në Komisionet Zgjedhore ad-hoc të Qendrës. Ky proces, edhe pse ishte më i avancuar se te subjektet tjera politike, pasi kandidatët i'u nënshtroheshin direkt votimit të aktivistëve, prapë se prapë ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm në hapjen e garës për më shumë kandidatë.

V. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata për raundin e parë të zgjedhjeve lokale zyrtarisht zgjati 30 ditë, edhe pse disa nga kandidatët kishin filluar fushatën shumë më herët duke shfrytëzuar hapësirat ligjore. Legjislacioni përcakton periudhën e zhvillimit të fushatës zyrtare, si dhe sanksionet e gjobat në rast të shkeljes së heshtjes zgjedhore, mirëpo, përveç tubimeve publike dhe vendosjes së materialeve për qëllime

³³ “Shkarkohet Omer Daku, Faton Bislimi gati ta udhëheq AKR-në”, Ora Info. Qasur më 28 janar 2014, <http://www.orainfo.com/?FaqeID=2&LajmID=27999>.

³⁴ “Daku: Erdha në krye të AKR-së me vizion për të fituar zgjedhjet lokale”, Rajoni Press. Qasur më 28 janar 2014, <http://rajonipress.com/shfleto-artikujt.php?id=9925>

³⁵ Lëvizja VETËVENDOSJE!, Statuti, Neni 81.1

elektorale nuk ndalon të bërit fushatë para hapjes zyrtare të saj. Zhvillimi i fushatës zgjedhore para afatit të përcaktuar dëmton kandidatët dhe subjektet tjera të cilat respektojnë afatet ligjore, pasi kanë më shumë mundësi për t'u promovuar si dhe nëse janë persona që mbajnë pozita publike zakonisht përqendrojnë fokusin në garën elektorale për të humbur efikasitetin në punët të cilat janë mandatuar t'i kryejnë.

Në përgjithësi, gjatë fushatës zgjedhore partitë politike nuk sollën ndonjë risi nga ato që jemi mësuar t'i shohim në fushatat e kaluara. Më së shumtë zunë vend tubimet me qytetar, kryesisht në grupe të vogla apo vizita derë-më-derë, për t'ju shmangur në maksimum tubimeve në palestra sportive apo në vende të hapura, përderisa qytetet u vërshuan nga afishet me imazhe të kandidatëve, por pa përçarur ndonjë mesazh përveç thirrjes për t'i votuar.


Përparësi të kësaj fushate në krahasim me të kaluarat ishte përkujdesja e partive për të përgatitur programe të shkruara, edhe pse shumica prej tyre u prezantuan shumë vonë, apo nuk ishin të detajuara dhe koncentroheshin në përshkrim të gjendjes ekzistuese nëpër komuna në vend të ofrimit të alternativave. Pastaj, përzjerja e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal konsumoi një pjesë të madhe të vëmendjes së publikut, veçanërisht premtimet milionëshe të kryeministrit për investime kapitale, jashtë mundësive buxhetore të Kosovës, apo gara se kush po premtonte më shumë vende pune. Premtimet parazgjedhore kaluan çdo fantazi dhe imagjinatë për t'u shndërruar shpeshherë në sarkazëm, kurse përgjigja më e shpeshtë që është dëgjuar kur ziheshin ngushtë për sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e këtyre projekteve ishte nga partneritetit publiko-privat.

Duke qenë se prej 7,929 kandidatëve në zgjedhje 1,904 ishin punonjës në shërbimin publik, apo rreth 24% e kandidatëve,³⁶ shfrytëzimi i resurseve të administratës publike për qëllime elektorale ishte shumë i shprehur. Përdorimi i veturave zyrtare në tubimet e organizuara nëpër komuna ishte bërë prej kryeministrit, ministrave, kryetarëve të komunave e deri te zyrtarët më të thjeshtë.³⁷

Gjithashtu, për qëllime elektorale nga komunat u shfrytëzuan edhe hapësirat reklamuese të rezervuar për informim të qytetarëve, e deri te përrurim i projekteve në kohë fushate, madje edhe të atyre të pa përfunduara, siç ishte rasti me objektin e ri të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, ku me ftesë të kryeministrit Thaçi, vendin e vizituan njëkohësisht kryeministri turk Erdogan dhe ai shqiptarë Rama.

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka bërë monitorimin e 25 ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale, nga të cilat 3 televizionet nacionale, 18

SHËRBYESIT PUBLIK NË ZGJEDHJE



³⁶ "Shteti në Zgjedhje", Instituti GAP. <http://www.institutigap.org/lajme/488>.

³⁷ Demokracia në Veprim. Shkurt, 2014. Raport i vëzhgimit të zgjedhjeve lokale 2013, fq. 19

televizione regjionale dhe lokale si dhe 4 ofrues të shërbimeve programore. KPM në fokus të monitorimit ka pasur edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe. Sipas raportit të KPM-së për javën e parë të fushatës,³⁸ mediat kanë raportuar kryesisht në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Gjatë javës së parë të fushatës, KPM ka pranuar dy ankesa për mos mbulim të fushatës zgjedhore nga mediat, ndaj të cilave ka ndërmarr veprime ligjore, si dhe ka identifikuar tetë media të tjera të cilat nuk kanë identifikuar reklamën politike apo kanë tejkaluar kohën e paraparë për spote politike. Për anim të hapur dhe promovim të një kandidati, KPM ka identifikuar vetëm një rast, por edhe deklarata preliminare e Misionit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve³⁹ ka konstatuar se televizion publik RTK 1 ka shfaqur preferenca të qarta në prezantimin e PDK-së në pushtet. Edhe gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, në raportin e monitorimit të mediave gjatë fushatës parazgjedhore kemi vërejtur anim të RTK-së për partinë në pushtet⁴⁰, që dëshmon lojalitetin e këtij institucioni publik karshi subjekteve të caktuara politike.

Fushata zgjedhore u karakterizua nga prania e shtuar e zyrtarëve të qeverisë së Serbisë në komunat me shumicë serbe në Kosovë, të cilët haptazi bënë thirrje dhe presion ndaj qytetarëve të komunitetit serb për të votuar listën qytetare “Srpska”.⁴¹ Kërcënimet u bënë në forma të ndryshme, përmes etiketimeve si tradhtar, kërcënimeve fizike, kërcënimeve për ndalje të asistencës sociale që ndahet nga qeveria serbe dhe formave të tjera. Qeveria e Kosovës u mundua të pengoj vizitat e zyrtarëve serb në kohë të fushatës, por vetëm përkohësisht, pasi edhe pa lejen e tyre ata hynë në territorin e Kosovës për qëllime elektorale.⁴²

Financimi i fushatave zgjedhore dhe shpenzimet

Shpenzimet e fushatës zgjedhore në Kosovë janë të kufizuara me ligj, pasi subjektet politike nuk mund të shpenzojnë më shumë se 0.5 euro për votues të regjistruar.⁴³ Nëse marrim numrin e përgjithshëm të votueseve të regjistruar, atëherë na del se subjektet politike të cilat garojnë në të

gjitha komunat, nuk mund të shpenzojnë më shumë se 886,869 euro. Para fillimit të fushatës zyrtare, pesë subjektet më të mëdha politike deklaruan se kanë planifikuar rreth 1.5 milion Euro⁴⁴ për qëllime të fushatës, edhe pse disa prej tyre nuk kishin hartuar as plane apo strategji të fushatës. Për financimin e fushatave zgjedhore të

Shuma e mjeteve të ndara nga Buxheti i Kosovës për qëllime të fushatës zgjedhore të subjekteve politike	
Për subjektet parlamentare	713,700 euro
Për subjektet jo parlamentare të përfshira në fletëvotim	79,300 euro
Gjithsej:	793,000 euro

³⁸ Shih raportin e KPM-së: <http://kpm-ks.org/?mod=njofitimet&id=632&gjuha=1>

³⁹ BE MVZ. 2013. *Deklaratë preliminare*. Shiko tek http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/preliminary-statement-in-kosovo-05112013_sq.pdf

⁴⁰ KIPRED. 2011. *Monitorimi i mediave gjatë fushatës parazgjedhore 2010*.

⁴¹ Raporti i Prokurorisë dhe deklaratat e Ivanoviqit dhe Petroviqit. Shik tek <http://www.zeri.info/artikulli/21234/beogradi-kercenon-serbet-votoni-srpskan>

⁴² “Ndonëse e ka të ndluar, Vulin futet në Kosovë”, Ikub. Qasur më 25 janar 2014, http://time.ikub.al/08dd788d4c/5713c12761383327664eb71d0032bb9f/Lajm_Ndonese-e-ka-te-ndaluar-Vulin-futet-ne-Kosove.aspx.

⁴³ KQZ, Rregulla zgjedhore Nr. 12/2013 për kufizimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore dhe deklarimi financiar, Neni 3.1

⁴⁴ “Partitë ‘deklarojnë’ 1.5 milion euro për fushatë”, Evropa e Lirë. Qasur më 25 janar 2014, <http://www.evropaelire.org/content/article/25124686.html>.

subjekteve politike, me propozim të Qeverisë, Kuvendi i Kosovës mund të ndaj mjete nga Buxheti i Kosovës por jo më shumë se 0.05% të shumës së përgjithshme të buxhetit.⁴⁵ Nga shuma e përgjithshme e mjeteve, 90% ndahen për subjektet në bazë të numrit të ulëseve në Kuvend, kurse 10% ndahen për subjekte tjera jo parlamentare të përfshira në fletëvotim.

Gjithashtu, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike parasheh pagesat e anëtarësisë, donacionet nga personat juridik në vlerë prej jo më shumë se dhjetë mijë euro brenda vitit kalendarik, personat fizik në vlerë prej jo më shumë se dy mijë euro brenda vitit kalendarik, por edhe nga veprimtaritë financiare fitimprurëse, si shitja e rekuizitave dhe materialeve promovuese të partisë,⁴⁶ të hyra këto që i nënshtrohen tatimit në fitim përkundër donacioneve për të cilat janë të liruara nga tatimi. Shfrytëzimi i të drejtës për të ushtruar veprimtari fitimprurëse për herë të parë u aplikua nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, përmes shitjes së rekuizitave dhe botimeve përmes internetit.⁴⁷ VV zhvilloi edhe kampanjën e quajtur “Dhuro për ndryshimin” me qëllim të mbledhjes së fondeve për fushatë zgjedhore nga kontributet e përkrahësve. Sipas zyrtarëve të VV-së, në 18 ditët e para të kësaj fushate ishte arritur të grumbullohen rreth 40 mijë euro, apo rreth 2,180 euro në ditë.⁴⁸

Të gjitha subjektet politike janë të obliguara të dorëzojnë Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës në Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim në KQZ, jo më vonë se 45 ditë kalendarik pas ditës së zgjedhjeve.⁴⁹ Ndërsa për publikun, raporti i shpenzimeve të fushatës zgjedhore mund të bëhet i ditura më së largu gjashtë muaj pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Raportin e shkurtuar të shpenzimeve të fushatës zgjedhore, si dhe atë vjetor financiar, subjektet politike janë të obliguara ta publikojnë edhe në njërin nga gazetatat ditore kombëtare, ndërsa raportin e plotë duhet të mbajnë të publikuar për së paku një vit në faqen e tyre zyrtare. Sipas raporteve jo zyrtare⁵⁰ mësohet se kostoja e shpenzimeve për fushatë zgjedhore të subjekteve politike për PDK janë rreth 800 mijë euro, LDK 768,691 mijë euro, AAK rreth 300 mijë euro, VV-së 259,396.33 euro. LDK dhe VV kanë qenë më transparente në deklarimin e shpenzimeve të tyre para afatit të paraparë ligjorë, pasi që kanë publikuar për mediat e shkruara vlerën e shpenzimeve,⁵¹ për dallim prej subjekteve të tjera që kanë qenë më të mbyllura për publikun.

VI. PROCESI ZGJEDHOR

Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve

Për të garuar në 38 komunat e Kosovë në zgjedhjet lokale, KQZ kishte certifikuar 103 subjekte politike, nga të cilat 33 parti politike, 2 koalicionet, 52 nisma qytetare dhe 16 kandidatët të pavarur. Nga numri i përgjithshëm i subjekteve të certifikuara, 51 ishin shqiptare dhe 52 nga komunitetet pakicë (28 nga komuniteti serb, 11 nga ai boshnjak, 3 nga komuniteti turk dhe pjesa tjetër komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë). KQZ kishte certifikuar 7,926 kandidatët për kuvendet

⁴⁵ Ligji Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, Neni 10

⁴⁶ Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, Neni 5

⁴⁷ Shih: vitrina.vetevendosje.org

⁴⁸ Dardan Molliqaj, prononcim për Gazetën Jeta në Kosovë, <http://gazetajn.com/?cid=1,1018,6583>

⁴⁹ KQZ, Rregulla Zgjedhore Nr. 12/2013, Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Neni 4.1

⁵⁰ Blakaj, Lumturie. 2013. “Partitë fshehin shpenzimet e fushatës”. Gazeta “Zëri”, 17 janar, faqe 5

⁵¹ Po aty.

komunale, të cilët garuan për 993 ulëse, prej tyre 30% femra falë kuotës gjinore, ndërsa prej 224 kandidatëve për kryetar të komunave vetëm 9 kandidatë ishin femra.

Dita e zgjedhjeve

Përveç që zgjedhjet janë një nga instrumentet më të rëndësishme në procesin e vendim-marrjes qytetare, zgjedhjet lokale 2013 ishin të rëndësishme edhe për të paktën dy arsye të tjera. E para, u organizuan pas manipulimeve masive që ndodhën në zgjedhjet e vitit 2010, dhe e dyta, për faktin se për herë të parë me ligjet e Kosovës u organizuan edhe në pjesën veriore të banuar me shumicë serbe.

Vëzhgimi

Për të rritur transparencën e procesit zgjedhor, 30,173 vëzhgues vendor dhe ndërkombëtar ishin akredituar në KQZ. Vëzhguesit e subjekteve të certifikuara për të marr pjesë në zgjedhje përbënin numrin më të madh (26,985), kurse pjesa tjetër përbëhej nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (2,479), si nga komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb, mediat (191), përfaqësues të Avokatit të Popullit, misionet diplomatike në Kosovë (210), si dhe organizatat ndërkombëtare (254).

- Koalicioni i OJQ-ve “Demokraci në Veprim” kishte të shpërndarë rreth 1,600 vëzhgues të stacionuar nëpër të gjitha vendvotimet;
- Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (ENEMO), kishte 34 vëzhgues të zgjedhjeve nga organizatat e saj anëtare të cilët kanë vëzhguar 221 vendvotime në të gjitha komunat e Kosovës përmes ekipeve mobile;
- Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (BR MVZ) kishte 99 vëzhgues mobil;
- Prokuroria e Shtetit, me 50 prokuror të shoqëruar nga njësit hetuese të Policisë së Kosovës, të përfshirë për herë të parë në teren gjatë ditës së zgjedhjeve.

Incidentet gjatë procesit të votimit

Në përgjithësi dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe pa incidente që mund të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.^{[52][53]} Hapja e qendrave të votimit ishte bërë me kohë, pa vonesa të theksuar dhe të pajisura me materialet e nevojshme. Gjatë votimit për zgjedhjet lokale 2013, janë shënuar 19 incidente në 2,366 vendvotime,⁵⁴ raste këto që kanë qenë të izoluara, kryesisht në formën e kërcënimeve apo të mbylljes së përkohshme të qendrave të votimit. Deri në orët e mbrëmjes procesi është zhvilluar normalisht edhe në katër komunat veriore, përkundër fushatës intensive që ishte zhvilluar atje për t'i bojkotuar zgjedhjet. Duke parë që fushata bojkotuese nuk po jepte efektet e dëshiruara, persona të maskuar morën përsipër që fizikisht të pengonin procesin zgjedhor në Mitrovicën Veriore. Në orët e mbrëmjes janë sulmuar qendrat e votimit në “Shkollën Shën Sava”, “Shkollën Teknike” dhe “Shkollën e Mesme të Mjekësisë”, ku kanë demoluar kutitë e votimit dhe kanë marrë listat e votuesve. Pas

⁵² BE MVZ. 2013. *Deklaratë preliminare*. Shiko tek http://www.eucpm.eu/files/pressreleases/other/preliminary-statement-in-kosovo-05112013_sq.pdf

⁵³ Demokracia në Veprim. 2014. *Raport i vëzhgimit të zgjedhjeve lokale 2013*.

⁵⁴ Po aty, faqe 31

këtyre sulmeve, përfaqësuesit e OSBE-së të cilët lehtësonin procesin zgjedhor në veri të Kosovës, ishin tërhequr nga këto qendra të votimit duke lënë gjithë materialin zgjedhore në duart e sulmuesve.⁵⁵ Këto incidente kanë nxjerrë në pah edhe dobësitë që kishin forcat e rendit atje.

Parregullsitë tjera

Rastet tjera të parregullsive të identifikuara gjatë ditës së zgjedhjeve ishin për qëndrim të personave të paaautorizuar në qendra të votimit, të cilët kanë tentuar të ndikojnë në përcaktimin e qytetarëve për të votuar, por edhe të asistimit të votuesve nga i njëjti person disa herë.⁵⁶ Në përpjekje të parandalimi të fenomenit të “votës së korruptuar”, KQZ në qendrat e votimit kishte vendosur materiale që tregonin se fotografimi i fletëvotimit është i ndaluar, megjithatë kjo praktikë vazhdon të mbetet e pranishme. Për më tepër, praktika e “votës së korruptuar” është avancuar në të ashtuquajturin “treni bullgar”, që realizohet përmes nxjerrjes së një fletëvotimi të rregullt nga vendvotimi dhe dorëzohet te blerësi i votës i cili qëndron jashtë, e që pastaj këtë fletëvotim të vulosur dhe të plotësuar ia jep shitësit të votës ta fus në kuti, e fletëvotimin e paplotësuar që e merr brenda ta sjell jashtë. Në këtë mënyrë blerësi gjatë tërë kohës ka një fletëvotim të rregullt jashtë vendvotimit, përmes të cilit sigurohet që votat në kuti janë ashtu siç ky është i interesuar. Pretendimet se një fenomen i tillë ka ndodhur gjatë ditës së zgjedhjeve i ka paraqitur VV, që mbështetej në argumentin se ka mos-përputhje në mes të numrit të nënshkrimeve në Listën përfundimtare të votuesve dhe numrin të fletëve brenda kutive të votimit.⁵⁷

Probleme të shumta janë identifikuar me Listat e votuesve si rezultat i mospastrimit të tyre nga personat e vdekur si dhe mos azhurnimit për ata të cilët kanë ndërruar vendvotimin e që kishin problem të gjenin emrin e tyre në listë për të votuar. KQZ, duke qenë e vetëdijshme për pasaktësinë e Listës së votuesve, në vendvotime kishte shpërndarë sasi më të vogël të fletëvotimeve sesa numri i votuesve. Votimi familjar edhe më tutje vazhdon të mbetet shkelje e shpeshtë në proceset zgjedhore. DnV-ja në deklaratën preliminare për ditën e zgjedhjeve kishte raportuar për mbi 200 raste të evidentuara për votim familjar.⁵⁸

Pjesëmarrja e votuesve

Numri i votuesve të regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale ishte 1,792,913 prej tyre 811,489 shfrytëzuan këtë të drejtë, apo 46.31%. Në këto zgjedhje u regjistrua pjesëmarrja më e lartë e qytetarëve në një proces zgjedhor krahasuar me shtatë palë zgjedhjet e kaluara, apo rritje prej 9.8% në krahasim me zgjedhjet e kaluara të vitit 2010. Nëse i referohemi përqindjes së qytetarëve që kanë marr pjesë në zgjedhje,

⁵⁵ “OSBE dhe DnV ikin nga maskat në Veri”, Gazeta JnK. Qasur më 28 janar 2014, <http://gazetajnK.com/?cid=1,1070,6934>.


⁵⁶ Demokracia në Veprim. Deklaratë preliminare. Shiko tek http://demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=showfull&id=1383508353&archive=&start_from=&ucat=&

⁵⁷ “Blerje industriale e votës”, Komunikatë nga VV. 8 nëntor 2013. Shiko tek http://www.vetevendosje.org/news_post/blerja-industriale-e-votes/.

⁵⁸ Demokracia në Veprim. Deklaratë preliminare. Shiko tek http://demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=showfull&id=1383508353&archive=&start_from=&ucat=&

atëherë kjo përqindje është dukshëm më e lartë për shkak të pasaktësisë së listës së votuesve. Përkundër disa iniciativave të KQZ-së për të pastruar listën e votuesve nga personat të cilët kanë ndërruar jetë si dhe ata që kanë hequr dorë nga nënshtetësia e Kosovës, lista e votuesve akoma mbetet e pasaktë.⁵⁹ Numri i personave të përfshirë në listën e votuesve është pothuajse i barabartë me numrin e përgjithshëm të popullsisë që është bërë në regjistrimin e fundit gjatë vitit 2011.⁶⁰

DALJA NË ZGJEDHJE



Në ora 19:00 është mbyllur procesi i votimit në të gjitha qendrat e votimit, me përjashtim të rasteve kur ka pasur votues në radhë të pritjes. Dita e zgjedhjeve dhe organizimi i tyre ishte më i avancuar në krahasim me zgjedhjet e mëhershme të organizuara nga vendorët. Numri i madh i vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar, paralajmërimet e bashkësisë ndërkombëtare se në rast të konstatimeve të keqpërdorimeve zgjedhore do të rrezikohet procesi i Stabilizim-Asociimit,⁶¹ pjesëmarrja e prokurorëve në teren si dhe rritja e dënimeve në Kodin Penal të Kosovës për rastet e manipulimeve zgjedhore, ndikuan që procesi i votimit të ishte më i rregullt dhe më demokratik. Megjithatë, akoma mbetet të përmirësohet Lista e votuesve, të aplikohen masa shtesë në parandalimin e “votës së korruptuar”, si dhe ndalimin e qëndrimit të personave të paautorizuar në qendrat e votimit.

⁵⁹ “Lista e papastruar shqetëson Komisionin”, Gazeta JnK. Qasur më 18 janar 2014, <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,1018,5716>.

⁶⁰ Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Kosova ka 1,739,825 banorë, kurse në listën e votuesve janë të përfshirë 1,705,272 votues me të drejtë vote. Shih, “Numri i votuesve afër sa i popullatës”, Gazeta JnK. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,5653>

⁶¹ Deklaratë e Ambasadorit Britanik, Ian Cliff, <http://sot.com.al/rajoni/cliff-manipulimi-i-zgjedhjeve-rrezikon-msa-n%C3%AB>

Shpallja e rezultateve

Për dhënien sa më të shpejtë të rezultateve preliminare, KQZ zbatoj projektin e quajtur “K-VOTE”, në shumë prej 325 mijë e 402 euro.⁶² Ky projekt përfshinte blerjen e 799 tablet PC të cilët u përdorën në të gjitha qendrat e votimit, koston e stafit të shpërndarë në të gjitha qendrat e votimit, si dhe pagesën për programin kompjuterik të dizajnuar nga I-vote, një kompani maqedonase. Fillimisht rezultatet u shpallën për daljen në zgjedhje në tri periudha kohore 11:00, 15:00 dhe 19:00, kurse mjaftë të shpejtë ishin edhe në paraqitjen e rezultateve preliminare për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale, me përjashtim të kandidatëve.

KQZ nuk ishte kaq efikase dhe në certifikimin e rezultateve përfundimtare, pasi vetëm pas 17 ditësh arriti të bëjë certifikim zyrtarë të rezultateve për Kryetarë të Komunave. Megjithëse, legjislacioni zgjedhor nuk përcakton afatet brenda të cilave duhet të shpallen rezultatet, pasi i vetmi kriter i përcaktuar është të përfundojnë të gjitha procedurat në vendvotime dhe në qendrat e numërimit, si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga PZAP.⁶³ Procedurat e komplikuara në QNR, mirëpo edhe procesi i numërimit të votave me kusht - që kërkon skenimin e të gjitha listave të votuesve - janë arsyeja kryesore për vonesa në rezultatet përfundimtare. Vonesa të theksuara kishte sidomos në publikimin e rezultateve të kandidatëve për kuvendet komunale që nuk u shpallën deri pas mbajtjes së raundit të dytë. Sipas informatave të KIPRED-it, përkundër se rezultatet ishin të gatshme, partitë e mëdha politike ishin pajtuar që rezultatet për kuvendet komunale të mos shpallën para mbajtjes së raundit të dytë. Në këtë mënyrë do të përfitohej nga votuesit e kandidatëve për kuvendet komunale, të cilët kanë votuar subjektet politike për hire të kandidatëve, dhe në rast të shpalljes së rezultateve, ata votues mund të mos merrnin fare pjesë në zgjedhje apo të ndërronin preferencat e tyre për kryetar të komunës. Gjithashtu, vonesat në shpalljen e rezultateve për kandidatët e kuvendeve komunale lë hapësirë për manipulim të procesit brenda kandidatëve të së njëjtit subjekt politik.

Zbatimi i projektit për shpalljen preliminare të rezultateve në mënyrë elektronike dhe online, ishte i suksesshëm dhe kontribuoi në uljen tensioneve që zakonisht prodhohen pas mbylljes së vendvotimeve, pasi partitë nxitojnë të shpallin fitoren ende pa nisur numërimi. Megjithatë, mbetet të përmirësohet numërimi i votave për kandidat të kuvendeve komunale dhe shpallja e rezultateve preliminare në kohë sa më të hershme.

Edukimi dhe informimi i votuesve

Edukimi dhe informimi i votuesve është obligim kushtetues i KQZ-së, që përfshinë njoftimin për procedurat e votimit - e që kishte pësuar ndryshime nga zgjedhjet e kaluara - pastaj informimin për të drejtat, procedurat për mbrojtjen e tyre dhe mekanizmat për ankesë. KQZ-ja ka obligim të veçantë të informojë edhe votuesit në viset rurale, ata me aftësi të kufizuara dhe analfabetët. Për qëllime të informimit dhe edukimit të votuesve, KQZ kishte kontraktuar dy kompani për të zhvilluar kampanjën informues në vlerë prej 166,692 euro. Edukimi dhe informimi i votuesve, nga kompanitë e kontraktuara nuk ishte realizuar në përputhje me kushtet

⁶² “KQZ-ja do të blej 80 iPad”, Kosovapress. Qasur më 13 janar 2014, <http://www.kosovapress.com/sq/mobile/nacionale/kqz-ja-do-te-blej-800-ipad-1579/>.

⁶³ Ligji Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 106.1


e kontratës, pasi shumë nga elementet e saj nuk ishin përmbushur apo ishin realizuar vonë.⁶⁴ Materialet e shpërndara për procedurat e votimit kanë qenë të mangëta pasi nuk kanë përmbajtur shpjegimet për votimin për kryetar të komunave por vetëm për kuvend komunal, ndërsa spotet për mënyrën e votimit janë transmetuar vetëm disa ditë para votimit.⁶⁵ Përveç lëshimeve nga kompanitë e kontraktuara, edukimi i votuesve ka çaluar edhe nga vetë KQZ-ja, pasi uebfaqja e saj, pjesa e edukimit të votuesve gjatë gjithë periudhës zgjedhore ishte e zbrazët dhe nuk ofron asnjë informatë.

Si rezultat i fushatës së dobët, në zgjedhjet lokale u shpallën 112,116 fletëvotime të pavlefshme, prej tyre 28,559 për kryetar të komunave, 70,782 për kuvendet komunale, ndërsa 12,775 fletëvotime ishin të zbrazëta. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme është rreth 12% e numrit të përgjithshëm të votave të hedhura në kutitë e votimit. Kjo shifër është tre herë më e lartë se në zgjedhjet e vitit 2010 (3.95%), apo nëse i krahasojmë me zgjedhjet në nivel lokal të vitit 2007 është dyfishi i tyre (5.55%), kur dihet se zgjedhjet e atij viti ishin më të komplikuar, pasi votohej për herë të parë me lista të hapura dhe sistem preferencial, si dhe organizoheshin tri palë zgjedhje njëkohësisht. Nëse krahasojmë numrin e fletëvotimeve të pavlefshme që nga fillimi i zgjedhjeve e para të lira, vërejmë se prej marrjes së kompetencave nga vendorët janë shënuar trend rritjeje. Apo nëse e krahasojmë në nivel rajonal, ta zëmë në Shqipëri ishin rreth 24 mijë (1.3%) fletëvotime të pavlefshme apo në zgjedhjet e kaluara lokale në Maqedoni rreth 38 mijë (3%).

Përveç fushatës së dobët informuese, faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme janë edhe trajnimet e dobëta të organizuara për komisionerët. Gjatë numërimit të votave, shumë nga komisionerët kanë shpallur si të pavlefshëm fletëvotimet në të cilat është votuar për më shumë se një kandidat për kuvend komunal, në vend se ato të numërohen si vota të vlefshme vetëm për subjektin politik.⁶⁶

Ankesat dhe Gjrobat

Në bazë të legjislacionit zgjedhor, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është organi



kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Të gjitha palët e përfshira në zgjedhje mund të paraqesin ankesa dhe parashtresa në PZAP brenda 24 orëve nga momenti kur pretendohet se ka ndodhur shkelja. PZAP është e obliguar që brenda 72 orëve të marr vendim në lidhje me ankesën e pranuar. Gjatë raundit të parë të zgjedhjeve, PZAP ka pranuar 1,011

ankesa dhe 45 apele, prej tyre 242 kishin të bëjnë me fushatën zgjedhore, 22 për thyerjen e

⁶⁴ “Heshtje zgjedhore e kompanive dhe KQZ-së për fushatë”, Gazeta JnK. Qasur më 23 janar 2013, <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,6835>.

⁶⁵ Po aty

⁶⁶ Ligji Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 104.3

heshtjes zgjedhore, 217 ankesa të tjera kanë të bëjnë me ditën e votimit, 245 për rezultatet preliminare (K-Vote) për kandidatet për anëtarë të Kuvendit Komunal si dhe 276 ankesat lidhur me rezultatet përfundimtare për kandidatet për anëtarë të Kuvendit Komunal.⁶⁷

Sipas të dhënave nga PZAP, subjekti politik i cili ka paraqitur më së shumti ankesa në këtë institucion është VV me 100 ankesa, e dyta renditet LDK me 47 ankesa, ndërsa PDK e treta me 35 ankesa. PZAP ka shqiptuar edhe gjopa ndaj subjekteve politike për shkelje gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Gjopat ndaj subjekteve politike në këto zgjedhje arrijnë shumën prej 184,500 euro. Gjopa më e lartë e shqiptuar ka qenë 5,550 euro ndërsa ajo më e ulëta 200 euro. Subjekti politik më i padisiplinuar në këto zgjedhje ishte PDK e cila u gjobit me 91,050 euro, e dyta renditet AAK me 37,650 euro ndërsa LDK është treta me gjobë prej 32,850. Asnjëra prej këtyre tri subjekteve politike si më të ndëshkuarat nuk kanë kryer obligimet në afatin e paraparë prej 15 ditësh. Në rastet kur një subjekt politike nuk paguan gjopat e shqiptuara nga KQZ apo detyrimet tjera, atëherë shuma përkatëse i zbritet nga buxheti që i ndahet nga Fondi përmes Kuvendit. Në rast se shuma e detyrimit është më e madhe sesa shuma që e realizon nga Fondi, atëherë subjekti nuk certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhje.

Rinumërimi

Gjatë raundit të parë të zgjedhjeve, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve u përball me sfida të mëdha. Një numër i madh i kutive të votimit, afër 500 sosh, nuk ishin konsideruar si të rregullta në bazë të procedurave të pranimit të materialeve, të cilat përfunduan në karantinë për hetime të mëtutjeshme.⁶⁸ Shumica e këtyre kutive, ishin hapur para se të arrinin në QNR, në zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore, për shkak se komisionerët nuk kanë pasur njohuri të duhura për paketimin e materialeve të ndjeshme dhe jo të ndjeshme. QNR rekomandonte në KQZ të bëhej hapja e këtyre kutive në mënyrë që të hetoheshin, para se të konsideroheshin si të rregullta. Si rezultat i hapjes së kutive, dhe lindjes së dyshimeve nga anëtarët e KQZ-së, shumë prej këtyre kutive u rinumëruan. Edhe pse procesi i hetimeve të këtyre kutive morri kohë, rinumërimi vërtetoi se rezultatet ishin shënuar në formular ashtu siç ishin shënuar nga votuesit.

Me rekomandim të QNR-së, KQZ kishte vendosur që për 62 vendvotime në territorin e Kosovës të bëhet rinumërimi i votave.⁶⁹ Deri te rinumërimi kishte ardhur si pasojë e mospërputhjeve të numrit të fletëvotimeve të pranuar, të përdorura dhe të papërdorura, apo mos-përputhjeve të tjera në formular. Po ashtu në disa raste është vërejtur se shiritat e thasëve të fletëvotimeve kanë munguar ose nuk janë shënuar në formularët e rezultateve. Për këto vendvotime, KQZ kishte kryer disa hetime, rezultatet e të cilave treguan se një pjesë e materialeve zgjedhore kanë munguar, siç janë lista përfundimtare e votuesve, formular i rezultateve, libri i votimit apo materiale të tjera që janë të ndjeshme. Gabime në fletëvotime dhe parregullsi ishin hasur për kandidatët për kryetar të komunave, për kuvende komunale por edhe në votimet me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta.

⁶⁷ Korrespondencë e KIPRED me PZAP përmes postës elektronike. 24 janar, 2014

⁶⁸ Intervistë e KIPRED me vëzhgues brenda QNR-së

⁶⁹ “KQZ çon në rinumërim 62 vendvotime”, Portali Lajmi. Qasur më 25 janar 2014, <http://lajmi.net/kqz-con-ne-rinumrin-62-vendvotime/>.

Një sfidë tjetër e pazakontë për QNR-në ishte pranimi i materialeve nga komunat e veriut, i cili ishte i shoqëruar nga OSBE-ja. Për shkak të dhunës dhe sulmeve në vendvotime në veri, një numër i konsiderueshëm i kutive të pranuar ishin të thyera, shumë prej materialeve të ndjeshme mungonin, duke përfshirë edhe listën e votuesve, pa të cilën vendvotimet nuk mund të konsiderohen të rregullta. Ndërkaq, me urdhër të PZAP-së, KQZ kishte rinumëruar fletëvotimet në 12 vendvotime në komunën e Klinës. Ky vendim është marrë pas një ankese të bërë nga LDK-ja, e të cilën PZAP-ja e ka vlerësuar si të bazuar dhe të mbështetur në fakte. Në arsyetimin e PZAP-së thuhet se në publikimin e rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ka mospërputhje të rezultateve në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në këto Qendra të Votimit për të cilat është vendosur të ketë rinumërim të votave në disa vendvotime të Klinës.⁷⁰ Nga rinumërimi në 12 vendvotime prej gjithsejtë 55 në komunën e Klinës, rezultojë me ndryshim prej vetëm 3 votave nga rezultatet përfundimtare.

Rivotimi

Si pasojë e dhunës së ushtruar nga grupe të maskuara në tri qendrat e votimit në Mitrovicën e Veriut, dhe mbylljes së parakohshme të vendvotimeve, KQZ kishte vendosur që më 17 nëntor 2013 të përsëriten zgjedhjet në këto qendra me gjithsejtë 17 vendvotime. Administrimi i zgjedhjeve në ditën e rivotimit u lehtësua sërish nga misioni i OSBE-së, ndërsa për sigurinë u përkujdesën forcat e shumta të policisë së Kosovës, EULEX-it dhe KFOR-it. Edhe gjatë rivotimit, sikurse herën e parë, në Mitrovicën e Veriut u lejua votimi edhe me dokumente të Serbisë, pavarësisht që votimi me dokumente të tjera përveç atyre të Kosovës nuk është i lejuar me kushtetutë.⁷¹ Duke marrë shkas lëshimet e sigurisë që ndodhën në raundin e parë në Mitrovicën e Veriut, me kërkesën e OSBE-së, sekretariati i KQZ-së kishte paraqitur edhe Planin B i cili u zbatua në raundin e dytë. Ky plan nënkuptonte bartjen e materialeve zgjedhore në QNR në Fushë-Kosovë ku edhe do të bëhej numërimi i votave, praktikë kjo jashtë rregullave ligjore të zgjedhjeve në Kosovë, të cilat përcaktojnë se numërimi duhet të bëhet në nivel të vendvotimit.

Rivotim pati edhe në tri qendra të votimit në komunën e Zveçanit. PZAP kishte marrë vendim⁷² që zgjedhjet të përsëriten në këto qendra për shkak se largimi i parakohshëm i OSBE-së kishte shkaktuar parregullsi serioze. Po ashtu edhe qendrat tjera ishin mbyllur në ora 17:00, dy orë më herët sesa që parasheh ligji. Në vendimin e PZAP-së thuhet se materiali zgjedhor, kutitë e votimit, listat e votuesve, janë lënë pa kurrfarë mbikëqyrjeje deri në orën 20:00. Rivotimi u vendos të mbahet më 1 dhjetor 2013, në të njëjtën kohë me raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave.⁷³

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave

Nëse pas raundit të parë të zgjedhjeve, asnjë nga kandidatët nuk arrin të marr më shumë se 50% plus një (1) votë nga numri i përgjithshëm i votave të hedhura për atë komunë, në atë rast ligji parasheh raundin e dytë të zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve më të votuar për kryetar të komunës. Në 38 komunat e Kosovës në të cilat ishin organizuar zgjedhje, vetëm në 14 prej tyre

⁷⁰ “KQZ vendosë që në Klinë të rinumërohen 12 vendvotime”, Kosova Live 360. Qasur më 19 janar 2014, <http://www.kosovalive360.com/kqz-vendos-qe-ne-kline-te-rinumerohen-12-vendvotime.html>.

⁷¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 45.1

⁷² PZAP. Vendimi Nr. Anr. 931/2013

⁷³ Rivotohet në Zveçan. KQZ. Shiko tek <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/142>.

ishite arritur që kryetari të zgjidhet që në raundin e parë, kurse në 25 prej tyre do të vendosej në raundin e dytë dhe atë në të gjitha qytetet e mëdha.

Ende pa përfunduar certifikimi zyrtar i rezultateve për kryetar të komunave nga ana e KQZ-së, partitë politike nxituan të lidhin koalicione me rivalët e tyre të deri djeshëm. Me nënshkrimin e koalicioneve u harruan akuzat - për keqpërdorim të fondeve publike, paaftësi qeverisëse, programe të porealizuara - për tu rreshtuar krah njëra tjetrës në përmbushjen e ambicieve për pushtet. Përmbajtjet e marrëveshjeve të koalicioneve qeverisëse asnjëherë nuk u bënë të ditura, cilat pika programore të partive në koalicion do të zbatoheshin, apo edhe nëse të paktën marrëveshjet ishin në baza programore apo krejtësisht për ndarje të posteve. Niveli qendror i partive ai që vendoste për koalicionet në nivel lokal, madje edhe ndërhynte kur ato lidheshin nga degët, siç është rasti i AKR-së në anulimin e koalicionit me PDK-në në Prizren.

Me vendim të KQZ-së, periudha e fushatës zgjedhore ka zgjatur 5 ditë, nga data 25 deri më 29 nëntor 2013. Në fakt, fushata zgjedhore nuk ishte ndalur që prej raundit të parë, me përjashtim të tubimeve publike të cilat mund të sanksionohen prej PZAP-së. Ashtu siç parashihet legjislacioni zgjedhor, zgjedhjet për raundin e dytë u mbajtën një muaj pas raundit të parë, më 1 dhjetor 2013. Në garë ishin të përfshirë 50 kandidatë për kryetar të komunave të Kosovës. Për të monitoruar procesin zgjedhor, përveç rreth 30 mijë vëzhguesve të akredituar nga raundi i parë që kishin të drejtë pjesëmarrje edhe në raundin e dytë, KQZ kishte akredituar edhe 900 vëzhgues shtesë,⁷⁴ kurse Prokurori i Shtetit ishte shpërndarë në teren me 60 prokurorë, 10 më shumë se në raundin e parë. Për të marrë pjesë në raundin e dytë të zgjedhjeve, në listën e votuesve ishin të përfshirë mbi 1,371,000 qytetar, prej tyre 548,909 shfrytëzuan këtë të drejtë apo 40,02% e votuesve.⁷⁵ LDK garoi në më së shumti komuna, në 15 duke fituar në 7 prej tyre, pastaj PDK garoi në 12 komuna dhe fitoi në 5, kandidatët e AAK-së që ishin në koalicion me ata të LDD-së votën e kërkuar në gjashtë komuna dhe fituan në 1, AKR fitojnë në dy komunat në të cilat garoi për të nxjerrë bilanc të 100% nga raundi i dytë, ndërsa VV sikurse edhe IQM, garuan vetëm në nga një komunë të cilat i fituan. Në gjashtë komuna të tjera garuan parti nga komunitetet, kryesisht serbe. SLS dhe GIS garuan në pesë komuna, në dy komuna tjera garuan kandidatët të SNPK-së dhe IQ-së e Oliver Ivanoviqit. GIS pati rendimentin më të lartë me fitoren në 5 komuna, ndërsa SLS me ndihmën e partive shqiptare fitoj në komunën e Shtërpçës.

Për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në aspektin e sigurisë, Policia e Kosovës kishte të angazhuar 5,100 zyrtarë policorë⁷⁶ në tërë territorin. Ndërkaq në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan u votua në 9 qendra, përfshi rivotimin në tri qendra në Zveçan. Në këto dy komuna me shumicë serbe, votimi u organizua nën masa të rrepta ushtarake dhe policore, ku zyrtarisht ishin të angazhuar 300 zyrtarë policorë, së bashku me përfaqësues të EULEX-it dhe KFOR-it. Para secilës qendër të votimit ishin të pranishëm mbi 30 zyrtarë të policisë, forca ushtarake të KFOR-it dhe policë të EULEX-it. Ndërsa në largësi prej 100 metra nga qendrat e votimit qëndronin edhe rreth 100 forca të tjera policore dhe ushtarake, shumë afër tyre ishin të pranishme edhe strukturat ilegale të ashtuquajtur "Mbrotjtja civile". I gjithë procesi në këto dy komuna me shumicë serbe ishte lehtësuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, sipas marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përkundër numrit të lartë të forcave të rendit, siguria kishte dështuar në komunën e Parteshit pasi

⁷⁴ KQZ, <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/143>

⁷⁵ KQZ, <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/147>

⁷⁶ Koha, <http://koha.net/?page=1,13,167495>

3 kuti të votimit u dëmtuan nga persona të paaautorizuar të cilët hynë në vendvotime. Për këto tri vendvotime në Partesh ku u dëmtuan fletëvotimet, KQZ vendosi të përsëriten zgjedhjet me 15 dhjetor 2013.⁷⁷

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave nga Prokurori i Shtetit u vlerësua si më i qetë në krahasim me raundin e parë. Gjatë ditës së zgjedhjeve dhe në tërë territorin e Kosovës, prokurorët kanë pasur 7 lëndë me 8 persona të arrestuar dhe të ndaluar⁷⁸ në raste të ndryshme si, pengim i procesit të votimit, armëmbajtje pa leje, keqpërdorim të detyrës zyrtare e deri te vjedhja e hard-disqeve me xhirime të hyrje-daljeve nga QNR. Ndërkaq, PZAP për raundin e dytë të zgjedhjeve ka pranuar gjithsej 53 ankesa, prej tyre 2 para fillimit të fushatës zgjedhore, 6 gjatë fushatës zgjedhore, 8 për thyerjen e heshtjes zgjedhore dhe 37 për ditën e votimit,⁷⁹ prej tyre AKR-ja ka paraqitur 2 ankesa, GIS-i ka paraqitur 2 ankesa, DnV-ja 10 ankesa, VV-ja 10 ankesa, BIRN-i 10 ankesa dhe PDK-ja 2 ankesa.⁸⁰ Përfshirja e Prokurorisë gjatë ditës së votimit dhe rritja e numrit të vëzhguesve kishin ndikuar pozitivisht në rritjen e besimit në procesin zgjedhor, dhe zvogëlimin e mundësive të manipulimit. Numri i ankesave të pranuar gjatë ditës së votimit për raundin e dytë ka qenë 24 më pak se në krahasim me të njëjtën periudhën të zgjedhjeve të kaluara 2009, ku ishin dorëzuar 61 ankesa dhe votimi ishte përsëritur në tri komuna (Prizren, Gjilan dhe Lipjan)⁸¹ si pasojë e manipulimeve gjatë ditës së votimit.

VII. REZULTATET PËRFUNDIMTARE

Edhe pse reforma e premtuar zgjedhore nuk ndodhi, zgjedhjet e kaluara deformuan vullnetin e votuesve, krimet zgjedhore nuk u ndëshkuan, prapëseprapë zgjedhjet e fundit lokale rikthyen votuesit në kabinat e votimit për të shënuar pjesëmarrjen më të lartë qytetare në një proces zgjedhor. Pjesëmarrja e lartë por edhe qasja shumë më serioze e institucioneve shtetërore dhe presioni ndërkombëtar mbi subjektet politike për të qenë më të përgjegjshme karshi procesit, garantuan zgjedhjet më të lira dhe më të drejta deri më tani, si dhe rikthyen besimin se nëpërmjet zgjedhjeve mund të bëhen ndryshime dhe mund të ndëshkohen politikanët për keqqeverisje.

Subjekti politik	Numri i këshilltarëve komunal
PDK	259
LDK	224
AAK	132
GIS	72
VV	69
AKR	41
SLS	26
Tjerat	171

Bilanci përfundimtar i zgjedhjeve lokale nxori PDK si subjektin më të votuar në nivel vendi me 27.11%, e pasuar nga LDK me 25.62%, AAK 14.03%, VV me 8.16% dhe AKR me 4.94%. Në komunat e banuara me shumicë serbe dominoi GIS me 49.42% e votave të këtyre komunave (apo 2,91% në nivel të përgjithshëm), e pasuar nga SLS me 19,49% (apo 1,11% në nivel të

⁷⁷ KQZ, <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/151>

⁷⁸ Prokuroria e Shtetit, Deklaratë. Shiko tek <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,531>

⁷⁹ Korrespondencë e KIPRED me PZAP përmes postës elektronike. 24 janar 2014


⁸⁰ “PZAP ka pranuar ankesa për balotazh”, Telegrafi. Qasur më 30 janar 2014, <http://www.telegrafi.com/lajme/pzap-ka-pranuar-ankesa-per-balotazh-2-38739.html>.

⁸¹ ENEMO. Zgjedhjet lokale 2009, raporti përfundimtar.

përgjithshëm). Megjithëse PDK fitoi numrin më të madh të votave nuk arrit t'i mbajë shumicën e komunave me të cilat kishte qeverisur – humbi Mitrovicën, Gjilanin, Ferizajn, Viti, Malishevën dhe Lipjanin, por ruajti Prizrenin dhe fitoi Kamenicën dhe Rahovecin për të marrë pushtetin në 10 nga 38 komunat. LDK riktheu Pejë, Gjilanin dhe Ferizajn por humbi Prishtinën, për të udhëhequr në 9 komuna. AAK nuk arrit t'i mbajë qendrat e mëdha për të fituar në 3 komuna të vogla si Deçan, Junik dhe Obiliq. AKR fitoj në Gjakovë dhe befasisht në Mitrovicën e Jugut për të marrë pushtet për herë të parë edhe në nivel lokal, së bashku me VV në Prishtinë dhe IQM në Malishevë. Refki Suma, si kandidat i pavarur vazhdon të udhëheq edhe për një mandat me komunën e Hanit të Elezit. GIS me fitoren në 9 komuna u shndërrua në forcën e tretë më e madhe në aspektin numerik, duke marrë primatin në mesin e subjekteve politike nga komuniteti serb dhe lënë pas SLS-in me vetëm komunën e Shtërpçës. Nga radhët e pakicave kombëtare fitoj edhe KTAP në Mamushë që përfaqëson komunitetin turk.

Nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve komunal, 338 janë femra kurse 665 meshkuj, apo të shprehura në përqindje 34% me 66% në favor të meshkujve. Nëse shikojmë numrin e femrave të përfaqësuara nëpër kuvendet komunale, më së shumti në përqindje janë në komunën e Hanit të Elezit (47%), Kamenicës dhe Kaçanikut (41%), si dhe Junikut (40%). Ndërsa më së paku femrat të përfaqësuara janë në kuvendin e komunës së Mitrovicës Veriore dhe Drenasit (26%), si dhe në Pejë (29%).

KËSHILLTARËT KOMUNAL NË ASPEKTIN GJINOR



Arsyeja e përfaqësimit të femrave nën 30% në këto komuna është për shkak të numrit të madh të subjekteve politike të cilat kanë fituar vetëm nga një ulëse, e që në shumicën e rasteve janë meshkuj. Formula e kuotës gjinore prej 30% për përfaqësim të gjinisë pakicë është e obliguar vetëm për Kuvendin nacional, dhe është e mundshme për shkak të vendosjes së pragut zgjedhor prej 5%. Në rast të kalimit të pragut,

subjekteve politike ju takojnë së paku 5 ulëse të cilat duhet t'i shpërndajnë në bazë të kuotës prej 30% për gjininë pakicë. Kurse për kuvendet komunal pasi nuk ka të vendosur prag zgjedhor, subjektet politike mund të fitojnë vetëm një ulëse dhe të përfaqësohen me kandidat të gjinisë shumicë. Në këtë rast përbërja e kuvendit komunal do të dominohet nga gjinia shumicë, madje mund të jenë tërësisht të gjinisë së njëjtë. Meshkujt dominojnë edhe në pozitën e kryetarëve dhe kryesuesve të komunave. Nga 38 pozitat e kryetarëve dhe kryesuesve të kuvendeve komunal vetëm nga një ju takojnë femrave. Respektivisht, në komunën e Gjakovës është zgjedhur kryetare Mimoza Kusari-Lila, dhe në Gjilan Valentina Bunjaku-Rexhepi kryesuese e kuvendit komunal, që është hera e parë në Kosovë që këto dy pozita ju takojnë femrave.

VIII. INAUGURIMI I KUVENDEVE KOMUNALE

Disa prej kryetarëve të cilët kishin humbur zgjedhjet nxituan që sa më shpejtë të dorëzojnë mandatin te kryetarët e ri, madje pa bërë betimin këta të fundit.⁸² Ligji për Vetëqeverisjen Lokale obligon të gjithë anëtarët e ri të kuvendit të komunës që brenda një muaji pas certifikimi të rezultateve të zgjedhjeve të nënshkruajnë solemnisht deklaratën e betimit, në të kundërtën pushojnë së qeni anëtarë.⁸³

Data 24 dhjetor ishte përcaktuar nga shumica e kuvendeve të komunave për të bërë inaugurimin solemn. Në katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok) seancat inauguruese kanë dështuar të mbahen tri herë radhazi, pasi kryetarët të cilët kishin fituar garën zgjedhore për të udhëhequr këto komuna e që vijnë nga Iniciativa Qytetare “Srpska” në vazhdimësi kanë mohuar të nënshkruajnë deklaratën e betimit me simbole të Republikës së Kosovës.⁸⁴ Mundësia e shmangies së betimit në komunat me shumicë serbe ishte diskutuar edhe në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë,⁸⁵ ndërsa përpjekje për t’i bindur kryetarët e ri që të respektojnë protokollin⁸⁶ e Kosovës janë bërë edhe nga përfaqësues të BE-së në Kosovë. Përpjekja e parë për të kryer inaugurimin është zhvilluar më 24 dhjetor, të cilën MAPL-ja e ka konsideruar si të parregullt meqë në ftesat e dërguara nga kryetarët e këtyre komunave ishte përdorur fusnota te emërtimi i Kosovës që nuk paragjykon statusin e saj dhe nuk ishte vendosur emblema e Kosovës⁸⁷ ashtu siç parasheh Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Pas dhënies së afati shtesë nga MAPL-ja për të plotësuar kërkesat ligjore, seanca e dytë inauguruese ishte mbajtur me datë 10 janar 2014, por kësaj radhe nuk ishin dërguar fare ftesa nga kryetarët e ri të zgjedhur meqë konsideronin se kjo seancë ishte vetëm vazhdim i seancës së kaluar dhe anëtarët e ri të kuvendeve komunale i kishin njoftuar vetëm përmes telefonit me qëllim që të vlenin ftesa e para në të cilat shprehej qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Seancat konstituive në herën e dytë janë bojkotuar nga përfaqësues të partive shqiptare dhe nga ato serbe të SLS-it për shkak të pranisë së simboleve të Republikës së Serbisë në sallën e inaugurimit dhe mungesës së atyre të Republikës së Kosovës. Përpjekja e tretë për të mbajtur seancat konstituive u zhvillua me 12 janar 2014, kur ishte edhe mundësia e fundit për të mbajtur mandatet e fituara pasi kalonte afati ligjor prej një muaji për të kryer betimin dhe verifikuar mandatin.

Më në fund, kryetarët dhe anëtarët e kuvendeve të komunës së Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit nënshkruan deklaratat e betimit. Në Mitrovicën e Veriut ishte situatë tjetër, Krstimir Pantiq i cili kishte fituar garën për kryetar dhe tre prej anëtarëve të kuvendit komunal që vijnë nga Iniciativa Qytetare “Srpska”, refuzuan të japin betimin për shkak të prezencës së simboleve të shtetit të Kosovës në deklaratë. Në të vërtetë, në deklaratat e betimit që duhet nënshkruar nga

⁸² Kryetari i Komunës së Pejës, Ali Berisha kishte dorëzuar detyrën të nesërmen te kryetari i ri i zgjedhur. Shih, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,17,167773> Ngjashëm kishte vepruar edhe ai i komunës së Gjakovës, Pal Lekaj.

⁸³ Ligji Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 35

⁸⁴ “Pantiq: Kemi 9 perfektë që nuk e njohin Kosovën e pavarur”, Gazeta Tribuna. Qasur më 30 janar 2014, <http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=33921>.

⁸⁵ “Betoheh edhe kryetarët serbë”, Gazeta Tribuna. Qasur më 30 janar 2014, <http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=34836>.

⁸⁶ “Në Veri refuzohet logoja e Kosovës, pranohet vetëm ‘Kosovo*’”, Telegrafi. Qasur më 30 janar 2014, <http://www.telegrafi.com/lajme/ne-veri-refuzohet-logoja-e-kosoves-pranohet-vetem-kosovo-2-39767.html>.

⁸⁷ “Pantiq s’i respekton rregulloret e MAPL-së”, Portali Koha. Qasur më 30 janar 2014, <http://koha.net/?page=1,13,171147>.

përfaqësuesit e ri komunal, stema e Kosovës ka qenë e mbuluar me letër-ngjitëse.⁸⁸ Në tentim për të kënaqur apetitet e të dyja palëve, MAPL-ja kishte dërguar deklaratat e betimit me stemë të Republikës së Kosovës por të mbuluara me letër-ngjitës, veprim ky kundër ligjore dhe si i tillë lirisht mund të cilësohet si falsifikim i dokumenteve zyrtare. Të nesërmen, raporti i MAPL-së për rrjedhën e seancave inauguruese,⁸⁹ rekomandonte përsëritjen e zgjedhjeve në komunën e Mitrovicës së Veriut pasi kryetari i zgjedhur nuk kishte verifikuar mandatin përmes procedurës së betimit ashtu siç parashihet.

Në komunat e Kosovës qendrore me shumicë serbe (Novobërdë dhe Graçanicë) betimi ishte kryer në të njëjtën ditë me komunat e tjera dhe pa kundërshtime, ndonëse ishin identifikuar parregullsi. Në seancën e inaugurimit në Graçanicë nuk kishte simbole të Kosovës por vetëm të Serbisë, madje i pranishëm ishte edhe ministri pa portofol i Serbisë Aleksandër Vulin si dhe ai i MAPL-së së Kosovës Slododan Petrovic. MAPL-ja e ka konsideruar si të parregullt seancën inauguruese në Graçanicë, dhe ka kërkuar që ajo të përsëritet. Vazhdimi i seancës ishte mbajtur tre ditë më vonë⁹⁰ në prezencën të zyrtarëve të monitorimit të MAPL-së, me simbole të shtetit të Kosovës por edhe të Serbisë.

Kryetari i Skenderajt, i cili ndodhet në paraburgim ishte liruar nga Gjykata e Apelit dhe EULEX-i për të bërë betimin, por pa praninë e medieve dhe publikut. Ndërkohë në Prizren seanca inauguruese ishte bojkotuar nga asamblistët e Bashkimit Demokratik, pasi kryetari i rizgjedhur edhe për një mandat është nën hetime për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe sipas tyre i “pandehuri” që ushtron postin e kryetari të komunën shumë shpejtë do të shkoj prapa grilave.⁹¹

Përkundër marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga BE-ja, për pjesëmarrjen e komunitetit serb në zgjedhjet lokale me ligjet e Kosovës, dhe pas shumë lëshimeve nga pala kosovare, mund të konkludojmë se konstituimi i organet e vetëqeverisjes lokale në komunat veriore nuk dha rezultatet e pritura dhe nuk arsyetoj kompromiset e bëra. Dështimi i njëpasnjëshëm i seancave të inaugurimit dhe rezistenca e organeve të zgjedhura atje për të nënshkruar deklaratat e betimit me simbole të shtetit të Kosovës, rrezikoj gjithë procesin e dialogut, që kësaj here shpëtoj falë improvizimit me letër-ngjitës. Në rastet kur seancat inauguruese në komunat me shumicë serbe janë cilësuar si të parregullta, MAPL ka lëshuar komunikata për media në të cilat ka konstatuar se nuk i kanë plotësuar kërkesat ligjore, por pa specifikuar se cilat janë ato kërkesa ligjore, ndonëse bëhej fjalë për mohim të shtetit të Kosovës nga kryetarët e komunave të saj.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Mitrovicës Veriore

Refuzimi i Kërstimit Pantiq për të nënshkruar deklaratën e betimit si kryetar i zgjedhur në komunën e Mitrovicës së Veriut, detyroi Presidenten e Kosovës të marrë vendim për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në këtë komunë.⁹² Gara për të parin e komunës ishte e balancuar në

⁸⁸ “Stema e mbuluar me letër-ngjitëse”, Portali Lajmi. Qasur më 30 janar 2014, <http://lajmi.net/stema-e-mbuluar-me-leter-ngjitese/>.

⁸⁹ MAPL, Informatë për media, <http://mapl.rks-gov.net/Main-menu/News/Informate-per-Media-%283%29.aspx>

⁹⁰ MAPL, <http://mapl.rks-gov.net/Main-menu/News/Deklarate-per-Media.aspx>

⁹¹ “Berisha: Prizreni shpejt në zgjedhje pas burgosjes së Ramadan Mujës”, Bota Sot. Qasur më 31 janar 2014, <http://botasot.info/lajme/259620/berisha-prizreni-shpejt-ne-zgjedhje-pas-burgosjes-se-ramadan-mujes/>

⁹² KQZ, <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/161>

aspektin etnik, pasi nga katër kandidatët dy vinin nga subjektet politike shqiptare dhe dy nga ato serbe. Në mesin e kandidatëve ishte edhe Oliver Ivanoviq, ndaj të cilit paraprakisht një prokuror ndërkombëtar nga Prokuroria Speciale e Kosovës kishte ngritur akuzë për krime të luftës dhe vrasje të rëndë pas konfliktit. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, Ivanoviq ndodhet në paraburgim, pasi konsiderohet si person i rrezikshëm që mund të kërcënojë dëshmitarët apo të ikë nga hapësira e juridiksionit.⁹³ Përderisa Ivanoviq nga Gjykata konsiderohet si person i rrezikshëm, i tillë nuk është edhe për KQZ-në, e cila e ka certifikuar atë për të garuar në zgjedhje. Legjislacioni zgjedhor ndalon certifikimin e kandidatëve për të garuar në zgjedhje nëse janë dënuar me vendim gjyqësor për veprë penale me një ose më shumë vite burgim,⁹⁴ por jo edhe atë të cilët janë nën hetime.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Mitrovicës Veriore u mbajtën më 23 shkurt 2014, edhe kësaj here me lehtësim të misionit të OSBE-së. Votimi u organizua në shtatë qendra të votimit me gjithsej 28,429 persona me të drejtë vote. Nga numri i përgjithshëm i personave me të drejtë vote, 5,890 shfrytëzuan këtë të drejtë, apo 20.72%. Paraprakisht, Agjencia për Regjistrimi Civil, që vepron në kuadër të MPB-së, ia ka dorëzuar KQZ-së edhe një listë të veçantë me 12 mijë emra të serbëve nga Mitrovica Veriore, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës.⁹⁵ Prej tyre 6,992 persona mendohet të jenë përfshirë edhe në listën preliminare të votuesve. ARC, KQZ dhe institucionet tjera nuk kanë dhënë informacione lidhur me këto shqetësime të ngritura nga opozita dhe mediat, duke krijuar një situatë të dyshimtë e cila përbën shkelje kushtetuese dhe ligjore.

Ofrimi i sigurisë fizike për votuesit dhe sigurimi i materialeve zgjedhore ishte sfidues, për të lënë në hije manipulimet eventuale të rezultateve. Forca të shumta policore dhe ushtarake ishin angazhuar në ditën e votimit. Para secilës qendër të votimit qëndronin rreth njëzet ushtarë të KFOR-it, pjesëtarë të policisë së EULEX-it dhe atë të Kosovës. Ndërsa nga tre pjesëtarë të policisë së EULEX-it qëndronin brenda secilës qendër të votimit, që është në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor, pasi forcat e rendit nuk mund të hyjnë në qendrat e votimit nëse nuk raportohet për incidente. Gjatë kohës së votimit nuk janë vërejtur as strukturat ilegale të ashtuquajtura “Mbrotjtjes Civile”, që ishte karakteristikë në tri raundet e kaluara. Masat e rrepta të sigurisë dhanë rezultatet e pritura, pasi në përgjithësi procesi ishte i qetë dhe pa incidente.

Gjatë ditës së votimi janë identifikuar edhe turma të votuesve të cilët në mënyrë të organizuar u janë drejtuar kutive të votimit, ka pasur probleme me listat e votuesve, por edhe votimi me dokumente të Serbisë. Përmbyllja e procesit zgjedhor dhe zgjedhja e strukturave të reja legale për herë të parë në pjesën veriore të Kosovës kishte bërë që shumë nga kriteret ligjore dhe standardet e zgjedhjeve të mënjanohej. Rezultatet preliminare të nxjerra nga KQZ, shpallin fitues kandidatin e Iniciativës Qytetare “Srbska” me 52.6% të votave, duke shmangur raundin e dytë dhe daljen e qytetarëve për herë të pestë në zgjedhje për të zgjedhur kryetarin e kësaj komune.

⁹³ EULEX, Komunikatë për media. Shiko tek <http://www.eulex-kosovo.eu/al/pressreleases/0553.php>

⁹⁴ Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 54.1

⁹⁵ “ARC regjistroi në mënyrë të paligjshme 7 mijë votues serb”, Illyriapress. Qasur më 13 shkurt 2014, <http://illyriapress.com/arc-regjistroi-ne-menyre-te-paligjshme-7-mije-votues-serbe/>.

IX. REKOMANDIMET PËR REFORMËN ZGJEDHORE

Pas dështimit të komisionit ad-hoc për reformë zgjedhore, të përfundoj me kohë detyrat e marra përsipër, Kuvendi i Kosovës ka mandatuar Komisionin për Legjislacion të bëjë ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ndryshimet në kornizën ligjore të zgjedhjeve nuk do të prekin edhe ndryshimet kushtetuese, të cilat janë esenciale për të përmirësuar sistemin zgjedhor. Kësisoj, publiku duhej kënaqur me disa ndryshime kozmetike, për të shpresuar në rihapjen e reformës së njëmend zgjedhore pas zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. KIPRED është ftuar nga komisioni për të qenë pjesë e grupit punues për ndryshimin e ligjit, ku disa nga rekomandimet tona tashmë janë inkorporuar në draft-ligj, kurse disa të tjera nuk janë marrë parasysh. Sidoqoftë, ne ofrojmë rekomandimet e plota si më poshtë, të cilat mund të bëhen pa prekur ndryshimet kushtetuese:

1. Kohëzgjatja e fushatës zgjedhore

Në shqyrtimin e para të ligjit nga Komisioni për Legjislacion nuk kishte konsensus në mes të anëtarëve për kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore. Përgjithësisht, disponimi i shumicës së subjekteve politike është të shkurtrohet fushata zgjedhore nga 30 ditë sa është tani në 15 ditë. KIPRED konsideron se shkurtimi i fushatës zgjedhore dëmton subjektet e reja të cilat synojnë të përfaqësohen në Kuvend. Koha e shkurtër e fushatës kufizon paraqitjet mediale të subjekteve të reja si dhe vështirëson prezantimin e programeve dhe kandidatëve në të gjitha komunat për të gjitha subjektet.

2. Pragu zgjedhor për subjektet politike

Pragu zgjedhor për subjekte politike duhet të ulet nga pesë (5) përqind në tre (3) përqind, pasi si i tillë favorizon partitë e mëdha dhe dekurajon pjesëmarrjen e partive më të vogla dhe atyre rajonale. Në kohën kur demokracia në Kosovë ende nuk është konsoliduar, subjekte politike nuk janë të profilizuara dhe vazhdojnë të mbesin të mbyllura për individ të ri, duke mos respektuar demokracinë e brendshme, pragu më i ulët zgjedhor do të ishte promotor i mirë në nxitjen e këtyre zhvillimeve.

3. Kandidatët e pavarur pa prag zgjedhor

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (Neni 20), njeh të drejtën e kandidatëve të pavarur për të marrë pjesë në zgjedhje si dhe të drejtën për t'u zgjedhur. Mirëpo kjo e drejtë e garantuar në masë të madhe cenohet me vendosjen e pragut zgjedhor (Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 111.2, paragrafi a), pasi kandidati i pavarur për të marrë një vend në Kuvend duhet të grumbulloj sasinë e njëjtë të votave që subjekteve politike në atë rast do t'ju takonin më shumë vende. Kësisoj, pragu zgjedhor për kandidat të pavarur është diskriminuese në raport me subjektet politike, pasi edhe gara në mes tyre është e ndryshme. Kandidati i pavarur garon për një vend në Kuvend kurse subjektet politike për më shumë vende. Ky rast është në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, që bazohet në parimet e mosdiskriminimit, (Neni 7.1), si dhe të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes (Neni 45.2), pasi vota nuk është e barabartë në mes kandidatit të pavarur dhe subjekteve politike. Andaj, rekomandojmë të hiqet pragu zgjedhor për kandidat të pavarur në

nivel qendror, dhe ndarja e vendeve në Kuvend të bëhet me 1% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme.

4. Favorizimi i bartësit të listës

Ligji për Zgjedhjet Lokale (Neni 7.5) favorizon bartësin e listës në nivel lokal pasi në mënyrë automatike marrin të gjitha votat të cilat i takojnë subjektit të tyre. Kësisoj, bartësit e listës nuk i nënshtrohen garës zgjedhore si pjesëmarrës të barabartë me kandidatët e tjerë. Ky akt përbën edhe shkelje kushtetuese, pasi është votim me lista gjysmë të mbyllura, e kushtetuta përcakton se listat duhet të jenë të hapura (Neni 64.1). Kushtetuta e Kosovës (Neni 24.3) mundëson përdorimin e masave për të promovuar të drejtat e individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Por, ky rregull assesi nuk mund të vlejë për bartësit e listës pasi nuk janë kategori e diskriminuar - përkundrazi e privilegjuar - dhe si i tillë duhet të eliminohet nga niveli lokal, dhe nuk duhet lejuar të rikthehet në atë qendrorë ashtu siç po pretendohet.

5. Heqja e votës preferenciale

Një ndryshim domethënës do të ishte që votuesit të votojnë vetëm për një kandidat, për dallim prej votimit për dhjetë kandidatë në vitin 2007, dhe pesë kandidatë në zgjedhjet e vitit 2010. Votimi për një kandidat mundëson të dihet pesha elektorale e secilit kandidat dhe ndikon që në baza meritore të forcojnë pozitën brenda subjektit. Përveç kësaj, votimi për një kandidat i aplikuar në zgjedhjet e fundit lokale, ka thjeshtësuar procesin e votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, por edhe ka minimizuar manipulimet brenda subjektit.

6. Sistemi i listave të hapura

Kosova duhet të vazhdojë të ketë një sistem zgjedhor që praktikon listat e hapura. Çdo qytetar duhet të gëzojë të drejtën për të votuar për kandidatin për të cilin mendojnë se do të jetë përfaqësuesi më i mirë i vlerave dhe interesave të tyre. Së dyti, listat e hapura rrisin llogaridhënien dhe përgjegjësinë e politikanëve, pasi që ata më nuk duhet të falënderojnë udhëheqësit që janë emëruar si deputetë të Kuvendit. Me fjalë të tjera në afatgjatë listat e hapura do të motivojnë partitë që të përgjigjen drejtpërdrejtë në nevojat e votuesve dhe të fuqizojnë lidhjen midis votuesve dhe deputetëve. Listat e hapura i japin mundësinë e njëjtë secilit kandidat të partisë, dhe do të duhej të fuqizonte këta individë pasi që votuesit do të votonin për ta e jo për partinë.

7. Votimi me kusht

Votimi me kusht shërben për të gjithë ata të cilët nuk mund të gjejnë emrin dhe mbiemrin e tyre në Listën Përfundimtare të Votuesve. E drejta e votimit me kusht zakonisht është praktikë e vendet post-konflikt pasi konsiderohet se votuesit mund të kenë ndërruar banim dhe nuk mund të gjejnë emrin dhe mbiemrin e tyre në atë vendvotim ku ju është caktuar. Në kohën kur është hartuar legjislati zgjedhor në Kosovës, vendosja e votimit me kusht ka qenë e arsyeshme për shkak të lëvizjeve të shumta nëpër vendbanime si pasojë e luftës. Tani, katërmëdhjetë vite më pas, votimi me kusht nuk duhet të përfshihet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, pasi nuk i

shërben qëllimit fillestar, si dhe është arsyeja kryesore për vonesën e KQZ-së për të certifikuar rezultatet, si dhe është burim i shumë manipulimeve zgjedhore. Heqja e votimit me kusht duhet të përcillet me fushatë për edukimin e votuesve për përditësimin e adresave të tyre në regjistrin civil.

8. Votimi jashtë Kosovës

Votimi jashtë Kosovës është një proces mjaftë i ndërlikuar dhe i kushtueshëm pasi realizohet përmes postës. KQZ duhet të kryej përgatitje të veçanta për këtë operacion si dhe shkakton vonesa në numërimin e votave. Do të ishte më e pranueshme sikur votuesit jashtë Kosovës të përfshihen në një listë të veçantë e cila do të verifikohet më lehtë, si dhe të ishte e vlefshme vetëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Ndërsa për zgjedhjet lokale votimi jashtë Kosovës duhet eliminuar, pasi që konsiderohet se qytetarët të cilët nuk jetojnë në atë komunë nuk janë mjaftë të informuar me problemet lokale.

9. Kabinat e Votimit

Ndonëse legjislacioni zgjedhor nuk përcakton formatin e kabinave të votimit, ato deri më tani kanë qenë të larta dhe të vendosura me shpinë të votuesit kah muri. Disa nga teknikat e manipulimit të zgjedhjeve të përdorura deri më tani janë kryer përmes fotografimit të fletëvotimit, apo tërheqjes së një fletëvotimit nga vendvotimi me qëllim të realizimit të ashtuquajturit “treni bullgar”. Kabinat e votimit duhet të kthehen me shpinë nga vëzhguesit – por duke ruajtur fshehtësinë e votës – apo të shkurtohen deri në atë masë që pjesa e sipërme e votuesit të jetë e dukshme për vëzhguesit në mënyrë që të kenë pamje të qartë nëse do të kishte fotografim të fletëvotimit apo tentim për të tërhequr atë jashtë vendvotimit. Nëse realizohet ky operacion teknik, do të parandalonte në masë të madhe dukurinë e shitjes së votës.